




REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E DRENASIT  
KUVENDI I KOMUNES



Nr.06-49780 dt. 24.06.2016

**Mbledhja e rregullt  
Kuvendi Komunal  
30.06.2016**

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më  
dt.30.06.2016

Mbledhjen e kryesoi **NAIM BAZAJ** – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit  
Komunal ku të pranishëm ishin 28 anëtarë

Kuvendi filloi punimet më këtë :

**Rend dite:**

1. Pyetje dhe pergjigje
2. Proces verbali i mbledhjes të dt.10.06.2016
3. Projektkorniza afatmesme buxhetore komunale 2017-2019

*Prezentuan: Kryetari i Komunes z.Nexhat Demaku ,perfaqësues te  
KFOR-it, perfaqësues të OSCE-së perfaqësues të mediave si dhe  
qytetarë te Komunës se Drenasit*

Takimi filloi punimet në ora 10 :15

**NAIM - BAZAJ** - Shpalli te hapura punimet e kesaj mbledhje i cili i njoftoj te pranishmit me rendin e dites dhe kerkoi nga të pranishmit se a pajtohen më këtë rend dite, apo keni ndonje propozim :

**KRYETARI I KOMUNËS-NEXHAT DEMAKU-** propozoi që në rend dite të hyjë edhe një propozim vendim per ridestinim te mjeteve kapitale nga projektet e mbeturat.

**NAIM BAZAJ**-hodhi në votim rendin e dites me një pikë shtesë të propozuar nga kryetari:

Me rastin e votimit prezent ishin 20 anëtarë:

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:18

Kunder:0

Abstenim:02

**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin per piken e parë të rendit të dites

### 1.Pyetje dhe pergjigje

**SOKOL BYLYKBASHI**-pyeti kryetarin e komunës se si do të veproj me personat që kanë aktakuzë në administraten e komunës e në këtë rast si do të veprosh me derejtoreshen e sherbimeve publike a do ta shkarkosh nga detyra apo jo.

**VEHBI BERISHA**-ne mbledhjen e kaluar ne i kemi parashtru pyetjet presim pergjigjet

**MILAIM HAJDARI**-i ka prashtru disa pyetje anëtarja e kuvendit Sabrije Kukaj në mbledhjen e kaluar unë do të perpjekem tu japë pergjigje:njëra prej pyetjeve ka qenë pse po uzurpohen pronat publike brenda qytetit e në këtë rast zonat gjelbruese para lokaleve,unë kamë angazhuar stafin dhe kanë dalë në teren per të vertetuar gjendjen faktike ,shumica prej këtyre i shfytëzojnë terasat para lokaleve me leje dhe i kanë kryer edhe pagesat për shfrytëzim te kësaj prone e kjo ndodhë gjatë sezonës se veres,por sa i perket zones urbane ne nuk jemi kompetent per këtë qështje është drejtoria e urbanizmit në këtë rast.

**IDRIZ HYSENAJ**-kerkoj nga drejtorija e inspepcionit qe ne rrugen perballë banesave është e vendosur një tabelë ne kahje per parking e në këtë rast qytetaret po i parkojnë automjetet gabim dhe po kanë probleme banuesit ne ato biloqe te banimit ajo duhet të ndryshohet dhe te merr kahjen kah parkingu.

**NEXHMEDIN BALAJ**-kjo formë pyetje dhe pergjigje nuk po me pelqen fare po pasi është në rend dite unë kisha kerku nga inspeksioni që gropat që janë hapë nga punëkriesit e sidomos një grop është shumë e madhe dhe me ujë në Komoran me pasë parasysh dhe mundësish ajo duhet te mbyllte se ekziston rreziku me u mbytë dikush u kanë mirë ata njerzë te cilet i kanë shfrytëzu ata me shku edhe me i mbylli ato gropa.

**MILAIM HAJDARI** –ne kemi punuar në teren për këtë qëllim dhe i kemi vizituar ato gropa kudo që kanë paraqitur kerkësë banoret e edhe ne jemi te interesuar që ku kemi mundësi do të intervenojmë

**SABRIJE KUKAJ**-pati edhe një kerkësë dhe deklaroj se në mbledhjen e kaluar ne si anëtarë te kuvendit jemi manipuluar me marrjen e nje vendimi për dhënje te prones në shfrytëzim në komoran ku ai i shfrytëzon me teper pronë se sa është marrë vendim dhe atë pjesen tjeter e ka japë me qira që në këtë rast kisha kerku që ky vendim te pezullohet per atë pronar i cili ka uzurpuar.

**KRYETARI I KOMUNËS-NEXHAT DEMAKU**-askush nuk mundë te shfrytëzoj pronë me teper se sa e ka me vendim ,ne i bajmë kontratat dhe per derisa pronari nuk kthehet në kufijtë që ne i kemi dhanë pronen ne nuk nenshkruajmë kontratë.

**MUZAFERE KASTRATI**-unë kamë një pyetje per kryetarin,pse ne asnjë vend në asnjë rrugë nuk gjendet emri i heroit të kombit "SHABAN POLLUZHA"

**RIFAT BILALLI**-unë e di se me propozim ka qenë që parku i qytetit të emrohet me emrin e "SHABAN POLLUZHES DHE MEHMET GRADICES",se qka u ba pasandej unë nuk e di.

**LIMAN KRASNIQI**-drejtori i inspepcionit deklaroi se sa i perket zones urbane ne nuk jemi kompetent kjo nuk qendron, se pikrisht është drejtoria e inspepcionit ajo që per qdo vendim që merr drejtoria e urbanizmit te dalë në teren dhe të verifikoj se me të vertetë a është duke e zbatuar vendimin e marrë pronari apo jo,dhe në këtë rast duhet një koordinim në mesë te drejtorive duke filluar nga drejtoria gjeodete ajo e urbanizmit dhe drejtoria e inspepcionit që vendimet te zbatohen në teren,e sa i perket vendeve që po germohen në këtë rast ata janë perjegjes dhe duhet që vendet ku punohet ta bëjnë sigurimin e vendit ku punohet dhe te vedosin rrrethojat,por kisha kerku edhe nga inspektioni që në komoran te rrathi ta kenë parasysh që te zgjerohet ajo pjesë se edhe trotuari është zanë në atë pjesë,unë e di se është kompetencë e ministrisë por në këtë rast drejtoria gjeodete duhet te konstatoj se ku ka pronë te usurpuar te lirohet është sektori per pronë që është edhe perjegjës per këtë qështje.

**KRYTARI I KOMUNËS-NEXHAT DEMAKU**-sa iperket zgjerimit te rruges në komoran ju e dini se ajo është rrugë regionale është kompetencë e ministrisë,ne si komunë kemi punu trotuarin deri tek lagja zogu atje pasi që është rrugë shumë e rrezikshme dhe ka levizje shumë të qytetarëve edhe pse nuk ka qenë kompetencë e jona,ne zakonisht kemi bere kerkesë me na ndihmu në projekte ministria dhe në këtë vitë janë kater projekte që do të investoj në komunen tonë,e edhe nenkalimi në llapushnik dihet është në kompetencë të MTTk-së

**LIMAN KRASNIQI**-sa i perket nenkalimit në llapushnik dihet se është kompetencë e Ministrisë por aty komuna është dashtë paraprakisht me i zgjedh kontestet pronësore dhe me definu pronen është kompetencë e drejtorisë gjeodete me kry këtë punë

**KRYETARI I KOMUNËS-NEXHAT DEMAKU**-është bërë modë kjo është pyetje politike e sokolit ,është e pamundur kur punojmë e mos me pasë edhe lëshime. Edhe mu me akuzojshin per banesen që është pronë e komunës prej 2011 neper procese por që para dy tri dite ne jemi shpallë te pafajshem dhe ajo banesë që kontestohej dhe akuzoheshim u vertetua me deshmit që i ofruam ne se se është pronë e komunës,por pamvarësish kësaj ne po demtohem ne aspektin politik,dhe për këtë unë kisha kerku që te mos nguteni se per deri sa lënda është ne proces dhe nuk e konfirmon gjykata se janë fajtor apo jo ne nuk guxojmë te themi se është fajtor dikush,i kemi te gjitha deshmit se ai kamion ka ardhe prej se jashtmi dhe është edhe raporti i komisionit që e ka pranu dhe janë te gjitha specifikat që janë kerku per gjendjen e kamionit.

**NAIM BAZAJ**-i njoftoj te pranishmit se është i interesuar një investitor zviceran per ndertimin e një fabrike ne komunen e drenasit ku minimumi do ti punësoj rrëth 100 punëtor dhe në këtë rast unë kisha propozuar që disa prona komunale që janë te lira dikund te korrotica ti shpallim per dhenjen në shfytëzim për këtë qëllim.

**VEHBI BERISHA**-kerkoj që drejtoria perkatëse dhe komuna në këtë rast me bisedu me ministrinë e tregtisë dhe me u njoftu sakt se per cilen pronë bëhet

fjalë pasi që edhe ministria ka një projekt që në atë zonë ka me investu dhe te definohet sakt per ku është fjala.

**LIMAN KRASNIQI** -unë e perkrahu këtë propozim që e dha kryesuesi por komuna e drenasit ka një marrëveshje me ministrinë e tregtisë që në atë zonë do të investohet,dhe mire është që te merret një vendim per investitor te huaj që janë të intersuar të investojnë ne komunen tonë.

**NAIM BAZAJ**-hodhi në votim keto parcela që te shallen me një vendim paraprak zonë per dhenjen në shfrytëzim te ketyre pronave si:parcela nr 258-1 , 258-2 dhe 258-3

Me rastin e votimit prezent ishin 22 anëtarë.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:22

Kunder:0

Abstenim:0

**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin per piken e dytë të rendit të dites:

### **2.Proces verbali i mbledhjes të dt.10.06.2016**

Pasi që nuk pati vrejtje dhe diskutime për këtë pikë të rendit të dites

**NAIM BAZAJ** –hodhi në votim këtë pikë të rendit të dites:

Me rastin e votimit prezent ishin 22 anëtarë.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:22

Kunder:0

Abstenim:0

**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin për piken e tretë të rendit të dites:

### **3.Korniza afatmesme buxhetore 2017-2019**

**HAMDI KRASNIQI**-i njoftoj anëtaret e kuvendit me procedurat e zhvilluara që nga qarkorja e parë e drejtar e ana e ministrisë e gjë tek hartimi i kësaj kornize që sot po e diskutojmë dhe presim që te aprovohet

**RIFAT BILALLI**- kam një pyetje per drejtorin? sa eshte planifikimi i buxhetit si dhe a eshte reale kjo që është e paraqitur ne raport,drejtori Hamdi Krasniqi keto te dhana jane reale dhe jane % te perpunuara,nje pyetje per kryetarin,drjetorin e urbanizimi edhe pse nuk jane prezent ketu është fjala për faqen 9 tabela 3.2 është fjala për listen e financimit nga ministrit dhe donatoret të cilat projekte kanë edhe kontrat si: rruga Drenas- Gradic ,Abri-Likoc,rruga ne komoran,Terderc ndersa janë hjek disa rrugë si;rruga ne disa lagje ne baice si dhe rruga ne disa lagje ne Llapushnik,rehabilitim dhe asfaltimi i rruges Polluzhe -dashevc edhe pse është nenshkru kontrata per kete rruge nuk figuron në listen e projekteve si dhe asfaltimi i rruges sankoc,por kame verejtje edhe ne performancen që e kanë paraqite drejtorit e që ne fakt nuk dihet as vizioni,misioni dhe qëllimi ashtu siq është dashtur, e vtmja drejtori që i ka paraqitur si duhet keto qeshtje është drejtoria për ekonomi dhe bujqësi,kerkoj edhe nga K.P.F-ca që gjatë caktimit të projekteve të bejne nje vlersim me real pasi që nuk merren për bazë reliivi dhe vendi se si janë kushtet per punime por për të njejten gjatesi te rrugeve parashihet vlera e njejt e projekteve a që ne fakt është dasht të kene parasysh relievin,rast konkrtet permendi edhe rrethojat e shkollave që vlera nuk caktohet reale por e kunderta, dhe nuk shoh asnje projekt për kompjuterizimin e shkollave me kabinete e që ne fakt na duhen keto.

**VEHBI BERISHA-KABI** kerkon nje trajtim me te thellë edhe pse lista e projekteve kaptale nuk është perfundimtare,drejtori na njoftoj se jane perfill të

gjith procedurat deri ne hartimin e kesaj kornize, po une do te ndalem tek faqja nr.9 që ka te bej me listen e projekteve me bashkefinancim e që janë te perfshira vetem 7 projekte dhe ne kete rast kisha kerku nga kryetari edhe pse nuk është ketu që kur është fjala per bashkefinancim te projekteve, e që kemi te ndara vetem 30 mijë euro, ne fakt ne veteveti po kufizohemi dhe ne kete rast nuk kemi hapsir që të kerkojm edhe shtimin e projekteve me bashkefinancim, ne si komune ne kete rast duhet që per kete qëllim të ndajm mjete me shume dhe të bejm kerkesa neper ministri, që te investojn edhe më shumë projekte, ne kete rast ne gjate hartimit te projekteve, duhet te kemi parasysh që te kemi një muze ne drenas kemi arsyte mjeftushme per kete qëllim,kalojm tutje tek mallrat dhe sherbimet,edhe drejtori i permendi qe na lejohet një ngritje e perqindjes te kjo kategori e shpenzimeve e që ne fakt ka një rritje prej 4% dhe ne kete rast parashihet që qdo vite te kete rritje, une kisha pyetur se a ka dhe a do te kete rritje te shpenzimeve apo po e bejm kete vetem pse po lejohet kjo rritje, ndersa tek lista e projekteve kapitale kame një sygjerim që emri i projekteve te definohet sakt e jo te mbetet vetem financimi ne qyteten e komoranit pa e ditur se ne cilen lagje bahet fjal, ne si anetar te kuvendit kur te marrim vendim te dim sakt se per cilen rruge po behet fiale,si dhe projektet me bashke financim une kisha kerku që duhet te kete rritje te vleres se buxhetit

**HAKA TAHIRAJ-** ne kete raste une po ndalem tek drejtoria e urbanizimit, tek asfaltimi i rruges ne fshatin terdec a është vazhdimsi apo është ndonje rrugë re si dhe kanalizimi i ujrate te zeza ne lagjen Halilaj që është shumë nevojshme te cilat ujra te zeza vine para objektit te shkolles, që është veshtir te kalojet aty pari e që per kete rast kane verejtje edhe qytetaret e edhe prindrit qe i bien femijet aty,kame pyetje dhe per disa drejtori e ne kete rast eshte fjala per projektin që është parapa ndertimi i qendre rinore,une e di që qendra rinore është e ndertuar edhe është objekti, ma mirështë që keto mjete te behen bashk per ndertimin e shtepis se kultures dhe nuk ka nevoj te ndertojet qender e re rinore,drejtoria e sherbimeve publike – ne qdo vite po ndajm buxhet per ndertimin e vorrezav dhe perseri eshte parapar ky projek a ne ne fakt nuk e dim se ku eshte ber ndertimi i projekteve per varreza,është fjala edhe per një lagje ne terdec ku jane 5 familje dhe nuk kane rruge ata nuk jane duke kerkuar asfalt por vetem shtruarjen me zhavor te kesaj rruge dhe vetem te behet e kalushme kjo rruge pasi që është gjendja shumë keqe ne kete lagje.

**LIMAN KRASNIQI**-e salenderoj drejtorin e finacave per disa sqarime po pikerisht edhe une do te ndalem tek vizioni,misionidhe qëllimi që e kane paraqitur drejtorit dhe parafolsi im që ceku me heret,por une do te ndalem tek d.Urbanizmit,e sherbimeve publike dhe ajo e gjeodezise,tek d.Urbanizmit pikerisht po ndalem tek planifikimi i dhenjes se lejeve te ndertimit që numri është vetem 25 ,a ne fakt ne e dim se sa ka ndertime dhe sa eshte duke u ndertura pse eshte nr.aq i vogel i ketyre lejeve që ne fakt ketu është një burim i te hyrave vetanaka dhe ka buxhet me shume,si dhe projekt per mbikqyrje te projekteve si dhe pranimi i punimeve per projekte duhet te harmonizohen pasi që ndryshon numri i planifikimit,tek d.Katastrale te bejn vellimin e matjeve katastrale që tokat bujqësore te shendrrohen ne toke ndertimore ,dhe ne kete rast isha ndal te investimet tek projektet kapitale dhe bashkefinancimi me donatoret e jashtem, dhe ne kete rast kisha kerku që te futet ne listen e projekteve kapitale kanalizimi ne komoranin III dhe te hiqet projekt per mbyqkyrje te projekteve kapitale dhe kjo vlerë te shkon per ndertimin e kanalizimit ne komoranin III

**NEXHMEDIN BALAJ**-ne edhe ne KPF-ca e kemi diskutu këtë strategji per zhvillim ekonomik dhe mir është që kjo strategji është hartuar dhe ka të perfshira të gjitha fushat si ne Administrat,Arsim, shendetsi dhe mirqenje sociale po ne do të ndalemi më shum tek drejtoria e urbanzimit, e në këtë rast të projektet kapitale se qka po planifikojm dhe në këtë rast ne duhet të kushtojm rendesi të veqant dhe të krijojm kushte në Arsim per nxenesit tanë, e po ashtu edhe ne shendetsi e që sot na mungojn edhe barrnat me esenciale për të ndihmuar personat me nevoj si dhe bujqësi te kete subvencione në vler me te madhe dhe ne nese është nevoja të bejm kerkesa ne ministri që të krijojm kushte me te mira per bujqit tanë, dhe kur kemi te bejm me listen e projekteve kapitale une sot shoh disa ndryshime që ne KPF-ca kemi vendos diqka tjeter, ndersa ketu shoh nje projekt tjeter te ri Blerjen e vetures ne vler prej 100.000.00 euro a ne fakt ka qenë projekt per shpronsim te pronave dhe në këtë rast reagoj drejtori i Financa dhe deklaroj që është gabim teknik,gjithashtu une kisha kerku që ne vitet na vazhdim shkollat tona te Arsimit të paisen me nxemje qëndrore pasi që është shumë e nevojshme.

**SOKOL BYLYKBASHI**-unë mendoj se sa i perket hartimit te kesaj kornize me teper kjo pregaditet vetem sa per të perm bushur një obligim ligjor e jo te behet një planifikim i mirëfillt dhe ashtu siq duhet, por ne kete rast une kisha permend dy elemente si:e para është te organizojm degjime publike me qytetaret dhe Administratort e fshatrave para se te behet planifikimi dhe e dyta sa i perket planifikimit buxheti të jete gjith perfshires dhe të jet i balancuar pasi që shum her na ka ndodh që disa fshatra jane perfshir me nje vler te madhe te projekteve,ndersa ka fshatra që nuk jane perfshir fare dhe kjo nuk është mir te ndodh perseri

**ISTREF ELSHANI**-une po ndaelm me teper tek lista e projekteve kapitale dhe konkretisht me intereson per fshatin Krajkovë kur ne nje korniz te mehershme kanë qen te parapara 90.000.00 euro te ndara per rruge,kanalizim dhe trotuar,ndersa tash e shoh që jane ber disa ndryshime ku kan qen te parapara 50.000.00 euro për rruge tash jane vetem 40.000 kanalizim dhe trotuar i kane hjek krejt dhe nuk ka asnje cent dhe ne kete ras e shoh se KPF-ca ketu ka ber ndryshime dhe i kane hjek 70% te mjetev ne fshatin tone dhe i kanë bart neper fshatra tjera ku ata vet jetojne e që nuk po me pelqen kjo form e ndarjes se buxhetit, dhe ne kete rast permendi disa fshatra prej tyre. para anëtarve te kuvendit deklaroj se Krajkova është i vetmi fshat që me mjete te veta ka investu ne te gjitha projektet që jane ndertuar ne fshatin Krajkove

**BUJAR THAQI**-ne kete rast pati nje pyetje se kur behet planifikimi i buxhetit a pyetet ndokush prej fashtit apo une si anëtar i kuvendit a po dikush ne lagje per caktimin e projekteve.une kam nje propozim që projekti i parapar per kanalizim ne lagjen Tahiraj jo të mbetet keshtu po te regjistrohet me projektin lagjia e e Lugut se edhe une kam të drejt si anëtar i kuvendim me kontribu ne kete drejtim

**NAIM BAZAJ**-hodhi ne votim propozimin e kryetarit

Me rastin e votimit prezent ishin 22 anëtar

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Per:20

Kunder:02

Abstenim:0

**NAIM BAZAJ-** shpalli të mbyllur këtë seancë rrëth orës 12 e 30 minuta

Proces mbajtësi  
Xhavit Nebihi





REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E DRENASIT  
KUVENDI I KOMUNES



Nr. 03/n-567/12 dt. 26/08/2016

**Mbledhja e rregullt  
Kuvendi Komunal  
31.08.2016**

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më  
dt. 31.08.2016

Mbledhjen e kryesoi **NAIM BAZAJ – Kryesues**

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit  
Komunal ku të pranishëm ishin 27 anëtarë

Kuvendi filloi punimet më këtë :

**Rend dite:**

1. Proces verbali i mbledhjes të dt. 30.06.2016
2. Raporti gjashtë mujor i Kryetarit të Komunës
3. Raporti i Auditorit te Përgjithshëm
4. Raporti financiar Janar-Qershori 2016
5. Propozim vendimet për ridestinim te mjeteve kapitale
  - a) Propozim vendim për ridestinim nga zyra e kryetarit
  - b) Propozim vendim për ridestinim nga DSHP dhe E
  - c) Propozim vendim për ridestinim nga DUPH
  - ç) Propozim vendim për ridestinim nga DSHMS
6. Propozim vendim për ndryshimin e rregullorës komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së shoqërive tregtare në territorin e komunës së Gllogocit
7. Informatë nga drejtoria e Urbanzimit për banesat prone komunale
8. Zgjedhja e komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe kerkesave të paleve për emërtim të rrugeve

**Prezentuan:Kryetari i Komunes z.Nexhat Demaku ,perfaqësues te KFOR-it, perfaqësues të OSCE-së perfaqësues të mediave si dhe qytetarë te Komunës se Drenasit**

Takimi filloj punimet në ora 10 :15

**NAIM BAZAJ** - Shpalli te hapura punimet e kesaj mbledhje i cili i njoftoj te pranishmit me rendin e dites dhe në këtë rast i njoftoj se hiqet nga rendi i dites nën pika a) të pika e pest e rendit të dites

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-dha një arsyetim rrëth ketij propozim vendimi dhe deklaroi se janë mjete te parapara per shpronësim por pasi që ne nuk kemi mundur te percaktohem se ku ti orientojmë keto mjete sot edhe unë kerkoj që kjo pikë te shtyhet per një mbledhje tjeter.

**SABRIJE KUKAJ**-kjo nuk është arsyetim kryetar se per shpronësim te lumi ne kemi pasëtelashë në qikatov të re u kanë mirë me banë zgjidhje ketu se per dy tre vete nuk duhet që projekti te humb apo te ndryshoj ,dhe te kaloj pa u perfunduar ajo pjesë këtë nuk e lejojmë.edhe qytetaret janë ne gjendje te mjerueshmenë në këtë pjesë.

**KRYETARI I KOMUNËS**-ne i zgjedhim vetem rastet ku është pronë komunale dhe bëhet shpronësimi e jo edhe ato prona private pengesat po i bëjnë ata vetë **LIMAN KRASNIQI**-pyeti a mos ka devijim te shtratit te lumi dhe deklaroi se me sa e di unë ekspropriimi i pronave rrëth lumi është bërë qysh moti por për këtë duhet ta dijë më së miri Drejtoria gjeodete i ka të dhënat për këtë

**XHAVIT DRENORI**-kerkoj që në rend dite te hyjë edhe një pikë e rendit të dites raport nga DSHPdhe E,per projektin shtrurja me zhavor e rrugëve ne territorin e komunës se Drenasit dhe te dimë sakt per secilin lokacion se sa është shtru dhe a ju kanë permbytje projektit pasi që unë kamë shumë dyshime se nuk është kryer puna ashtu siq ka qenë e paraparë,dhe nese ne sot nuk e diskutojmë ketu mua nuk me mbetet tjeter do tju drejtohem organeve te drejtësisë për këtë .

**KRYETARI I KOMUNËS** -kerkoj që propozimi i xhavitit te shtyhet per një mbledhje tejter dhe në këtë rast edhe kryesuesi kerkoi që ky propozim te shtyhet per një mbledhje tjeter

**NAIM BAZAJ**- propozoi që në rend dite te hyjë edhe një pikë e rendit të dites e ajo ka të bëjë me qështjen e punëtorëve të feroniklit

**LIMAN KRASNIQI**-kerkoj që propozimi i kryesuesit te hidhet në votim por ne si anëtarë te kuvendorit unë mendoj se duhet dalim me një deklarat në perkrahje e punëtoreve se kjo i takon qeverisë te merret me këtë qështje.

**NAIM BAZAJ**-hodhi në votim propozimin per diskutim rrëth qështjes se punëtorëve te feronikelit

Me rastin e votimit prezent ishin 22 anëtar

Rezultati i votimit ishtë si vijon:

Për:22

Kundër:0

Abstenim:0

**SOKOL BYLYKBASHI**-paraprakisht deklaroi se unë e kamë bërë një kerkesë kryesuesit që në rend dite të hyjë edhe diskutimi dhe zgjedhja e një anëtarë nga levizja vetëvendosje në KPF-ca pasi që jemi partia e dytë ne kuvend pas pdk-së

perfaqësohemi me anëtarë pas PDK-së e edhe me ligj na takon kjo e drejtë dhe ky komitet duhet të ndryshoj po per mbledhjen e radhes kerkoj perseri të hyjë në rend dite ky propozim i imi.

**NAIM BAZAJ**-hodhi në votim rendin e dites edhe me një pik shtes Diskutim për qeshtjen e punetorve te Ferronikelit

Me rastin e votimit prezent ishin 22 anëtar  
Rezultati i votimit ishtë si vijon:

Për:18

Kundër:0

Abstenim:04

**NAIM BAZAJ**- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të dites

**1. Proces verbali i mbledhjes të dt.30.06.2016**

Pasi që nuk pati diskutim rrëth kesaj pike te rendit te dites

**NAIM BAZAJ**- hodhi në votim këtë pik të rendit të dites

Me rastin e votimit prezent ishin 22 anëtar

Rezultati i votimit ishtë si vijon:

Për:22

Kundër:0

Abstenim:0

**NAIM BAZAJ**- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të dites

**2. Diskutim rrëth qështjes se punëtorëve teFerronikelit**

**IMER DELIU**-unë mendoj se për këtë qështje ne duhet ti drejtohem MMPh-apo Qeverisë dhe pas diskutimeve te dalim me një deklaratë

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-unë jamë pjesë e takimeve që janë zhvilluar deri me tanë ,nuk duhet te bejm politik ketu qeveria është duke u merrë më këtë qështje dhe tash vonë kemi pasë një takim menagjeri ka deklaru se besoj se shpejti puna do tyё filloj,janë kerku disa kushte që me liru prej disa obligimeve si është diskutu qështja e rrimes,qeveria do të marrë një vendim per këtë qështje,ne nuk duhet te behemi armiqësor protestat mendoj se nuk janë zgjidhje

**XHAVIT DRENORI**-kemi diku rrëthë 600 punëtor të komunës tonë që janë punëtor te feronikelit,unë mendoj se ne duhet ti dhamë një afat dhe atë vetëm deri me 05 shtator që xehja te mos bartet në maqedoni,unë nuk edi se si ka hesap me bart xeha në maqedoni ,po me politikan te korruptuar është problem më ba zgjidhje.

**LIMAN KRASNIQI**-sa i perket qështjes se punëtoreve në aspektin juridik qeverisë i takon të meerret më këtë qështje,ndersa per bartjen e e xehes ne maqedoni se a ka te drejte apo jo dhe sa a ka leverdi ne nuk e dimë po në këtë rast unë kisha kerku te hartohet një deklarat dhe ti paraqesim keto kerkesa si;1.te nderpritet bartja e xehes jashtë shtetit,ndersa per qështjen e punëtorëve te merret qeveria,2 ti ndihmojë punëtoret me mjete financiare3.ti eliminoj te gjitha siperfaqet ku ka marrë xeha

**SOKOL BYLYKBASHI**-fillimisht deklaroi se nuk është dashëtë te privatizohet feronkeli,deklarat te nxjerrim me duket se është vetëm një deklaratë politike,deshtëm apo sdeshtëm feronikeli ka prodhuar një efekt negativ por pati një pyetje për kryetarin:se me qfarë mjetesh juridike komuna mundë te kerkoj dhe të bëjë zgjidhje,sa i perket takses unë nuk medoj se kjo është ndonjë ndihmë por gjithë ky ekspluatim ndoshta edhe sot behet me leje te ndonjë zyrtari siq është shit ashtu edhe sot e njejtë ndodhë edhe e lejojnë me bartë xehen,por pse jo te mos bëjmë protesta për këtë qëllim.

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-unë mendoj se nuk ka nevojë per proteste më këtë qështje duhet te merret sindikata e punëtoreve

**IMER DELIU**-ne nuk munde te bejme zgjidhje ma mirë është që te nxjerim një deklaratë dhe te kerkojmë nga qeveria që te perkrahen punëtoret

**IDRIZ HYSENAJ**-po në këtë kuvend është kerku sa e sa herë që feronikeli te mbylljet se po na bënë tym tash qka,na kemi nevojë per punësim,ne këtë rast ne po dalemi jo mirë ne duhet te percaktohem si te veprojmë por kjo qështje i takon qeverisë shteti ka perqejësi për këtë,ne jemi me duar te lidhura dhe në këtë rast nese ti e pengon mundë te fitojnë te tjeret,

**NAIM BAZAJ**- hodhi ne votim këtë pik te rendit të dites dhe kerkoi që taksa ti hiqet per vitin 2016

Me rastin e votimit prezent ishin 22 anëtar

Rezultati i votimit ishtë si vijon:

Për:14

Kundër:06

Abstenim:02

**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin per piken e tret të rendit të dites

### 3.Raporti gjashtë mujor i Kryetarit të Komunës

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-dha një arsyetim rrëth raportit gjashtë mujo dhe deklaroi se ne jemi munduar që sa me shkurt dhe kuart të jetë raporti me qëllim që te mos jetë voluminoz si per ju po ashtu edhe per qytetarë që është i publikuar edhe në të faqe të komunës në mënyrë që ta kenë me lehtë për ta kuptuar,prandaj ju keni para vetes materialin dhe pres nga ju që te japni ato mendimet dhe sygjerimet e juaja

**SOKOL BYLYKBASHI**-doli në foltore dhe fillimi si tek projektet kapitale në Drejtorinë e urbanizmit ku pati vrejtje se punimet nuk po kryhen si duhet në teren, dhe prezantoi dy fotografi te projekteve per punimet që janë zhvilluar në kanalizimin te lagja e Goshanëve në Terstenik, ku operatori veq ka punuar shkel e shko pa i shtruar zhavor fare, dhe deklaroi se kjo qfarë po ndodhë me projekte në Komunen tonë është krim dhe po kjo punë pranohet nga zyrtaret e komunës,po në këtë rast kisha kerku nga te gjithë ata që i mbikqyrin keto projekte që te mos nenshkruajnë punë që nuk po kryhen se ju garantoj se te gjithë keni me shku në burg unë vetë ka me i denoncu aty ku shoh që puna nuk është kryes sipas projektit.

**VEHBI BERISHA**-ky raport ka një perparim por ka edhe disa leshime e që ne vazhdim do ti permendi si:fillimi po ndalem tek rapporti i auditimit e që ne fakt une shoh se është nivel i ulet i zbatimit të rekomandimeve ku prej 30 rekomandimeve të dhena janë zbatuar vetëm 8 prej tyre,ndersa të faqja 5 është shum shqetesuese humbja e shtetis, bashkëaddhetaret tane shum prej tyre marrin shtetsi tjera që është shqetesuese per ne,ndersa tek d.urbanizmit e kan fjalen te projekti i uje sjellsit që perfshin 10 fshatra të kesaj ane që do të kyqen ne kete ujesjells dhe ketu ceket takimi që është mbajtur me perfaqsuesit e kompanis se ujesjallsit, ndersa une e di që kryetari e ka permend sa her që ky projekt dhe firma që ka financuar cdi e zvicrres njeher ka ikur nga ketu, por me vjen mir që perseri është kthyer, që ky projekt të ralizohet edhe të perfundoj sa me parë dhe per këtë projekt edhe une edhe komisioni që është per monitorimin e ketyre projekteve e kemi vizituar vendin ku jane kryer punimet dhe kemi par se punet nuk jane kryer si duhet dhe gypi vende vende edhe është shpluar, dhe në këtë rast kisha kerku nga kryetari që të na njoftoj ma detajisht se deri ku ka mbrri puna në këtë projekt ,e që sipas mendimit tim është i

deshtuar ku nga ky projekt presin 10 fshatra te furnizohen me ujë ,dhe une mendoj se edhe gypat që janë vendosur nuk i plotesojn kushtet për furnizim të ketyre fshatrave.tek qeshtja e drejtoris se Arsimit kam një pyetje per d.e Arsimit se qka do të behet me pagesat e lehonave ku për qdo vit po na paraqiten probleme, pastaj rekrutimi i stafit nuk po behet si duhet dhe ka norma të cilat nuk plotesohen dhe ka edhe raste ku disa personave nuk ju shpallet vendi i punes, po ka edhe raste ku ruhen vendet e punes që në të ardhmen nese drejtorat largohen keto vende i ruajne per vete,dhe në këtë rast disa prej kandidatëve i kam sygjeru që ti drejtoshen këshillit të pavarur mbykqyres, pasi që gjatë konkurimit i kan plotesu të gjitha kriteret dhe nuk ju ka dhen norma e plotë, po ju kanë dhan vetem 10 ore ku di raste konkrete, dhe nese është nevoja une mund ta jap edhe me emer,në këtë rast po ju referohem edhe Rapoertit te Auditimit ku eshte ber një keqklasifikim pikorisht sa i perket kesaj qeshtje, sa e sa her e kemi diskutu këtë qeshtje dhe per kete qëllim ka pasur bartje te mjeteve prej vitit ne vit, dhe perseri po na perseritet i njejtë problem sikurse është e qellimshme kjo qeshtje, dhe kisha kerku nga Kryetari që ky problem te evitohet dhe të mos na peraqitet ma.tash do te ndalem pak të drejtoria e shendetsis ketu me teper ju është kushtuar rendesi një raporti statistikor se sa që është ndal ne punen dhe qeshtjen që i takon sikurse .d.Urbanizmit, nuk janë specifiku se qfarë është punuar dhe në këtë rast une isha ndal me teper se ne at se drejtoria e shendetsis të parashev mundesin po edhe ne si komun tu bejm nje zgiidhje Handikosit pasi që jane në një gjendje të mjerushme ne kete rast është objekti i vjeter i komunes se në të kunderten ata po vuajne veres shum nxet dimrit shum stohet ne ato baraka ku janë,pastaj e inkuraroj drejtorin e shendetsis që qeshtja e menagjimit ne qëndren e mjeksis familjare ne drenas ta permirsoni, pasi që aty menagjim te mirfillt nuk ka prandaj për kete jam bind edhe vet pasi që mungojn edhe mjetet ma elementare në këtë qender si skalper nuk ka që kushton vetem 25 cent, e sipas mendimit tim kjo nuk guxon me ndodh po të ishte fjala për një vler më të madhe qđo kush e kuption kete e ketu shihet se nuk ka menagjim te duhur në këtë qender dhe une mendoj se në këtë qënder duhet të merren masa,pastaj permendi edhe qeshtjen te Emergenca ku kane probleme dhe telashe stafi ne menagjim pasi që mungon siguria pse të mos jet prezent zakonisht një punëtor i sigurimit dhe të mbaj rend për ti evituar problemet që mund të ndodhin aty,pastaj kemi raste që nuk ka filma të rendgenit.

**XHAVIT DRENORI**-e pergezoj reportin si dhe zyren per informim e falenderoj që këtë raport e ka publiku ne ëeb faqen e komunes, dhe kjo ka një qëllim të mir se egziston trasparenca,unë do të ndalem vetem të tek tre digaster si tek ajo e Urbanizmit, inspeksionit dhe Arsimit,Tek urbanizmi na mungojn raporte ma të detajume,dhe ketu është fjala për projektet nga të hyrat vetanake,projektet që financohen nga grandet dhe kur është fjala për projektet e financaura nga grandet qytetaret janë të pa knaqur pasi që aty shkojn projekte kur dikush ndikon nga politika,si dhe unë kisha kërku nga drejtori se mbi qfar baze caktohen projektet që do të financohen nga të hyrat vetanake dhe projektet që do të financohen nga grandet qeveritare,rast konkret kam projektet në fshatin tone që do të financohen nga të hyrat e që ne munges të mjeteve projekti mund të mos ralizohet dhe kjo nuk është e arsyshme,une kam verejtje edhe në realizim të projekteve puna nuk po kryhet si duhet ne jemi vet deshmitar te asaj se bashku më komisionin gjatë vizitave në teren ,pra këtu ka zyrtar të korruptuar paramasat nuk janë profesionale,unë kam edhe deshmi prej dy

firmave dhe janë deklaruar se ka nga zyrtaret e urbanizmit që kerkohet nga punëkryesi të mos e kryen punen si duhet në teren dhe mjetet ti marrin se bashku kete zyrtar janë korruptuar deri ne shtëpia.Tek Inspektorjati pati një pyetje per drejtorin se sa ka të hyra në këtë drejtorat dhe sa është rritja e denimeve pasi që une kam pas qasje në dy lend dhe e kamë par se ketu ka denime vetem mandatore, rast konkret permendi objektin e ndertuar të ANA Benzit ne Korrethicë ku janë vendos shiritat dhe atë pes(5) her, dhe nuk është respektu ligji dhe kjo pron është ne komosacion, janë të njejtë zyrtar që i kanë vendos shiritat, dhe të njejtë zyrtar të cilet i kanë leshu leje se i ploteson kushtet për të mbajtur mbramjen e matures,ketu ja është korruptu dikush fort ja kryetari i ka borgj dikujt , të njejtë zyrtar kan marr pjes edhe ne vendosjen e shiriteit e edhe në leshuarjen e lejes ata janë:Ariana Sadiku,Haki Bekollı dhe Pajazit Hamza ky i fundit ka qenë edhe Kryetar,kemi rastin tjeter të nje objekti që është ndertuar ketu në drenas te rruga afer tregut e që thirret Behari dhe ka fjal dhe thuhet se për këtë objekt janë marr 40.000.00 euro dhe për këtë rast permendet edhe emri i yt Kryetar kemi nje audio -inqizim prej 30 min ku keto mjete janë paguar dy her njehet 15 mij euro per katin e shtate(7) ndersa 25 mijë euro per katin e tetë (8).Të qeshtja e Arsimit nese nje projekt punohet keq është nje dam financiar po nese një mesimdhënës pranohet pa kriteri në shkollai e qete nje gjenerat budall dhe behem një shtet budall,në vend që të punsojm njerz profesionista,dhe unë me 27.11.2015 kame kerku më u shkarku drejtori i Arsimit pasi që është duke punuar njerz pa konkurs dhe pa kriteri dhe e ka shti komunen borgj dhe është lista me emra që une e kame ate list, dhe keta janë njerz qoft militant partijak,qoft familjar apo edhe me pare, dhe per këtë jam bind edhe vet është shpall konkursi kam konkuru edhe une dhe të dhenat e mijë nuk jan dal siq janë gjoja gabim teknik se une jam duke Doktorruar,kam punime shkencore rrëth 10 vite kame punuar si profesor i Gjermanishtes rrëth 90-92% e nxenseve të mi e kanë kaluar testin ne institutin gjerman, ndersa unë pyes se sa është perqindja e nxenesve ne shkollave të mesme të cilet e kane dhen provimin ne gjuhën Angleze apo Gjermane nuk del as 10%,une jam thirri ne intervist dhe në atë intervist kam pasur pyetje që nuk me kanë takuar, nga personi që ka punuar dy djemt në menyr të pa ligjshme dhe pyetja ka qen se qka është vetevlersimi sipas nenit të kesaj rregulllore ,thuaje se une jam egspert ligjor i asaj lemjë,pastaj cilat janë keshillat e shkollës thua se jam drejtor shkolle , ne fakt une kam nje eksperienc 10-vjeçar ne 7 Universitetet i kam nga nje semester, dhe ketu me të vertet po del se keto intervista janë intervista klasike gojore për qka thon edhe kandidatet e tjer dhe po del ajo se për t'u punuar duhet ti plotesosh tri kriteri 1.Të jesh anëtar i kuvendit dhe të jesh zvarranik dhe ti pershtatesh Kryetarit 2.Më korruptu ndokan ne drejtorin e Arsimit dhe 3.unë jam mashkull.

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU-** ti më këtë po na fyeni se te gjitha ato femra që janë duke punuar janë motra tonë nena tonë ,une e di ambicjen tende politike dhe nuk po du me hy ne proces se si janë pranuar e qysh janë pranuar është ligji ai që e rregullon kete,dhe është afati i ankesave pse nuk e shfrytezoni këtë secili kandidat që menon që ju ka bërë ndonjë e pa drejt, e ka të drejten e ankeses,po ju themë një se ka moral shum ne politik mashum se që e mendojm ne vet, dhe asnjeher ne nuk kemi punuar as nuk kemi larguar drejtor pse kane bindje tjeter politike,edhe anetaret e kuvendit kane te drejt të punojn ne Arsim,dhe nje gjë duhet kuptuar konkurenca është e madhe për nje vend pune konkurojn 20 vete po pranohet vetem nje(1) 19 tjer nuk pranohen

edhe të gjith kandidatet tjer kan të drejten e ankeses nese mendojnë se ju ka bërë e padrejtë, asnjehher nuk kam nderhy ne proces dhe as nuk nderhy është komisioni që vendos dhe e vleron secilin kandidat,problemi ne Arsim e kemi zakonisht me qeshqerjen e lehonave ketu qëndron ajo se ligji na obligon që kjo kategori të paguhet.

**IMER DELIU**-kisha keru nga Kryesuesi dhe anëtaret tjer të Kuvendit që kur një anëtar i kuvendit fyeni ne duhet të distancohem i nga ai

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-mir është që të respektohen ata të cilet kan qenë gjatë vitit 98 ketu edhe pse nuk e din një gjuhe se sa ata që kane dal jasht dhe e kanë mesu një gjuhe,ndersa sa i perket ndertimeve qdo dokument ka afat , ka procedura që duhet te respektohen që nga fillimi e deri ne perfundim të objektit e per objektin ne fjal ne e kemi pasur një kerkes prej pronarit që ka kerku kompenzim se une po e lesqoja një pjes të tokes për trotuar, dhe ne ende nuk i kemi kthyer pergjigje se janë disa procedura që duhet të zhvillohen sa i perket kesaj qeshqerje,ndersa për objektin tjeter brezit të magjistrales ne kemi hartu një elaborat që duhet të ju bejm zgjidhje po kete problem e kanë edhe komunat tjera, ne i respekojmë planet toni rregulluse që i ka komuna.

**XHAVIT DRENORI**-po as ne emer të kryetarit nuk guxojn me i marr 40.000.00 euro

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-jo le te deshmon ai nuk ke nevoj me ju ban avokat ti, nese i ka marr dikush ai le të shkon ai e din ku është vendi , jo jo pse jo mos i merr persiper ti që ki personale diqka ne kete rast është okej .

**SABRIJE KUKAJ**-une kam një pyetje sa i perket mbi kulmit të ndertuar te banesave e që është ndertu pse nuk po i ipet leja e ndertimit ku më të vertet ju është ber një zgjidhje atyre banorve prandaj duhet që sa me par aty ti leshohet leja e ndertimit.

**MILAIM HAJDARI**-sa i perket funksionimit të denimeve mandatore jemi ndër komunat e para që e kemi angazhuar një permbarus privat për këtë qëllim dhe punet janë duke ecur mir,sa i perket ndertimit të objekteve të ndertuara në tokë bujqësore binduni së ka mijra e mijra objekte që po ndertohen në gjith teritorin e kosovës, dhe nuk po mund të ndalin keto ndertime,kur është fjala të ndertimi e objektit të ANA benzit në Sankoc po ju njoftoj se ne më koh ja kemi terhek verejtjen dhe i kemi vendos shiritat ne kemi vetem një vetur dhe një inspektor të ndërtimit zakonisht në teren dalin inspektor te se ciles fush që i takon, përveq inspektorit që ka si detyr për të kryer punen e tij në asistim shkojn edhe dy apo tre inspektor për ta ndihmuar atë, pse kjo ka ndodh që të njejt inspektor të jenë prezent dy her, heren e dytë pronari ka bër kerkes vetem për marrjen e pelqimit sanitari që se bashku më inspektorin i ka pasur dhe dy inspektor tjer vetem si shoqrues,ndersa sa i perket objektit tjeter në baz të projektit ideor ju ka leshu edhe leja.

**XHAVIT DRENORI**- Te nderuar koleg hipotetikisht po e zam qe Fatmiri është drejtor i inspektorjatit edhe ka marr informacion që po ndertojet një objekt pa leje edhe i ka qu tre inspektor ja kan ngjit shiritin e kan qu rastin ne polici edhe i kan dhan gjob, e kane qu edhe ne gjykat, ndersa kur vin te ky tash ju thot që ju dy me shku edhe me ja leshu lejen ku është ketu morali njeri.

**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin për pikën e katert të rendit të dites  
4.Raporti i Auditorit te Përgjithshëm

**VEHBI BERISHA**-më vjen mir që ka ardhur rapporti i auditimit para se ne të aprovojm buxhetin dhe sipas mendimit tim është nder rapportet më të vrazhta që ka goditur komunen e drenasit,une kete qeshtje e kam ngrit qysh vitin e kaluar dhe kam kerku që të behet një planifikim se qfar rekomandimesh do të ipen edhe cilat fusha do të auditohen gjatë vitit dhe të njejten gje është edhe në këtë raport ku auditori i per gjithshem në faqen 6 rekomandon qfar plani të veprimit do të parashihet në auditori dhe edhe më heret e diskutuan qeshtjet e keqklasifikimit të pagesave ku shum prej tyre është fjala për pagesat e të punsuarve janë ber me me vendime të qykates nga thesari ku shum prej tyre janë ber pagesa për zëvendesues punëtorve ne Arsim e që ne fakt janë mbi 260.000.00 euro, si dhe kategoria tjeter nga mallra dhe sherbime që perseri konsiderohen si keqklasifikim i buxhetit dhe në fakt ne faqen 9 auditori përseri cek se menajmenti nuk ka ndermarr asnjë veprim për të zbatuar për të adresuar rrezikun që paraqitet dhe ketu shihet, se punetoret tan më qëllim nuk e kane kryer këtë detyr ka qen mir që këta punëtor të bejn nje trajnim dhe të din sakt qëllimin e pagesave, rekomandimet që i ka dhen auditori në faqen 12 ku prej 18 rekomandimeve të dhena vetem 6 prej tyre janë zbatuar dhe per këtë qëllim une kam kerku që të behet nje plan i veprimit më qëllim të evitimit dhe zbatimit të rekomandimeve që i jep auditori, pastaj auditori cek edhe qeshtjen e auditimit në prokurim ku thot se sistematikisht vazhdon qeshtja e dobsive në këtë sektor dhe mir ka qen që ne prokurim të ngritet nje performanc se në të kunderten gjithher egziston rreziku për keqmenagjim dhe mos ralizim të projekteve, shpesh her ne arsytim menajert e programeve kan dhen arsyetim se nuk din se kujt ti drejtohen ne rastet kur nuk zbatohen rekomandimet, është komiteti i auditimit ai që duhet të fuqizohet dhe ti jep mbeshtetje njesis se auditimit e që ne fakt ky komitet ka mbajtur vetem 4 takime ne vit ka mundesi që të mbaj edhe më teper

**SOKOL BYLYKBASHI** –Raporti i auditorit të përgjithshëm sipas mendimit tim është një raport negativ, më këtë vertetohet me keq qeverisjen në faqën 11 të këtij rapporti ku paraqiten dobsitë e keq qeverisjes në komunë për llogaridhëni, problem që na paraqitet qdo vit është keq klasifikimi i bugjetit apo i shpënzimeve ku janë diku rrëth 300.000(mijë euro) që janë shpenzuar jo për paga por dikun tjetër dhe me vendim të gjyaktës këto mjete janë paguar për puntor të arsimit, poashtu me vendim të gjykatës rrëth 120.000(mijë euro) janë paguar edhe për projektet kapitale për pagat e zevendsimit të punonjsve, fjala është ktu per lehonat, ky problem po na paraqitet qdo vit, por krejt kjo qka mundet me ban drejtoria e arsimit është te behet nje planifikim me i mirë, jo te shpenzohet buxheti i miratuar per diqka tjeter, nga mallrat dhe sherbimet nga thesari janë paguar 130.000(mijë euro), si dhe nga kategoria e mallrave dhe sherbimeve nga operatoret ekonomik janë paguar 30.000(mijë euro)dhe per kete nuk e kam te kjart, qe ktu del se operatoret ekonomik ne vend qe ne ti denojm ata e kanë fitu kete të drejt dhe na kan denuar, rekomandimet e dhena nuk janë zbatuar vetem gjasht prej tyre janë zbatu, pastaj më vjën mirë që krytari është zotu se do t bëjë një vetvlersim të punonjshëm pra një plan për vëtdijesim, pastaj vetvlersimi i rrezikut ku thuhet se komuna nuk ka një plan te till, ku ktu mund te kete rrezik, ktu thuhet se komuna nuk i zbaton as rekomandimet e auditorit te brendshem, pastaj kemi dobsi sistematike ne prokurim, prokurimi është vendi ku po keqmenaxhohet, ku ipet vrejtje ne kete rast, se komuna nuk harton as një projekt ekzekutimi, nuk hartoher një kontrat e mirfillt dhe kete e

bejne me qellim pa i detajuar dhe specifikuar kontratat me qellim te keqperdorimit dhe realizimit te interesave te veta ne teren.Pastaj po permendi edhe bashkfinancimin e projekteve ku vlera eshtë 23.000(mijë euro), ku ka munges te raportit dhe nuk kanë raportuar për ketë qeshtje, dhe ketu eshtë rreziku nga ata qe i marrin keto subvencione dhe mund te keqperdoren, pastaj kur te bejmë me borgjet që i kan komunes ktu dihet se sa me pak te hyra edhe projektet janë me a pak te realizushme, sipas mendimit tim ky eshtë një raport negativ.

**SABRIJE KUKAJ**-Une nuk po du me mbrojt drejtorin e arsimit ne ketë rast por sa i perket pageses se lehonave ministria ne ketë rast nuk bënë as nje pagesë dhe faji nuk eshtë te komunat ktu, ky problem eshtë ne të gjitha komunat nuk eshtë vetem tek ne.

**XHAVIT DRENORI**-Eshtë mirë qe ka ardh ky raport me u diskutu ne kuvend pasi që kemi mundsin me u permirsu me rekomandimet qe i ka jep auditori i pergjithshem dhe fillimisht po ndalem ne qeshtjen nr dhjetë faqe 22 qe ka t bejë me qeshtjen e arsimit e qe eshtë prioritet i lartë i rrezikut, e që u cek edhe me lartë se keta 23 punonjes qe jane punsu jasht planit, dhe i kan marrë pagat duke e paditur drejtorinë e arsimit nuk janë lehona se un e kam listen ne tersi dhe e di se kush ka qenë ne pushim prej lehonave, po kta jan puntor te pranuar qoft familjar, qoft te angazhuar politik apo edhe të punsuar me para duke e korruptuar dikand:nderhyri Kryetari dhe e pyti cilien list je duke e shiquar sqaroma listen e lehonave apo atyre qe i kan zevendsuar, zevendsim mund te jetë edhe mashkulli ju lutemi ma sqaroni,Xhavit Drenori- ketë list edhe ju mund ta keni e ka avokati i komunes, kto vendime qe kan fituar te drejten me vendim te gjykates, ka edhe ne sall ktu prezent e din edhe ti se kush eshtë, por ka që une e di edhe me emer msimdhenes ne komoran qe e ka shit me para vendin e punes si:e ki sivjet Mufail Berishen, i cili e ka shit vendin e punes dihet kujt ja ka shit dhe sa para i ka marrë ket e din edhe ti drejtor, e ki rastin e Xhemajl Hajdinit,Kryetari i komunes-per hirë të qytetarve dhe janë kamerat prezent ta sqarojm rastin e Mufail Berishes dhe kerkoi nga drejtori të sqaroj kete rast.

Sadik Tahiraj-kerkoi te dihet me emer se kujt ja ka shit vendin e punes po ashtu edhe krytari pat te nejten kerkes le te dihet publikisht kush eshtë ai,Xhavit Drenori:u pergjigji Avdullah Thaqi ja ka shit qikes se drejtorit te kishnarekes me iniciativ te drejtorit te shkolles ,Xhemajl Hajdini ja ka shit profesorit te edukates fizike Jeton Bogiqit,perseri Xhavit Drenori e din edhe polici hetues keete qeshtje:Sadik Tahiraj qka ka than polici hetues:Xhavit Drenori e din ti qka ka thanë

Sadik Tahiraj:Une ekuptoj Xhavitin se eshtë para presionit që ka qenë në kete sallë në intervistim para komisionit që ende nuk eshtë shpall dhe nuk eshtë berë publik shpallja, po nje duhet ta dini te gjithë se drejtori i arsimit nuk pyet askend se kan ta pranoj ne punë e kan jo se eshtë ligji ai që percakton se kush i ploteson kushtet per punë e kush jo dhe nese ka shkelje atehher ka edhe pergjegjesi unë po ju sqaroi;,Xhemajl Hajdini ka shkuar ne pension dhe me konkurs ka ardh arsintari tjeter, ndersa Mufail Berisha eshtë mesimdhenes ne shkollen Xheladin Gashi n komoran, ka berë një kerkesë per pushim pa pagesë dhe unë nuk i kam dhenë pelqimin per kete, as një rast drejtori i arsimit nuk punson njerz pa konkurs,ndersa zevendsimin e lehonave me ligj si menaxher kemi te drejt ti bejm keto zevendsime pa konkurs, une e di se diskutimi im nuk i pelqen Xhavitet, por nuk eshtë mirë të njolloset arsimi, të njollosoen

mesimdhenesit, ju lutem te nderuar antare te kuvendit nese nuk del publikisht Xhaviti te kerkoj falje para mediav dhe ketij kuvendi per fymjen që i është berë femrave mesimdhene, në mbledhjen e drejtorve do ta bejë publik këtë rast, nuk është fer sot të fyhet gjinia femrore, prej kujt prej nje pretendenti që neser mendon me kan krytar komune e te jet profesor e qe ngel para komisionit se s ka dit qka është arsimi nuk e din as sot e as neser, din me majt kshilla per 20 vjet.

Xhavit Drenori-une jam duke u konsulltar me prokurorin dhe nese më lejohet une do ti bejë publik emrat e te gjithë atyre te cilet janë punuar pa konkurs, dhe do ti shihni edhe ju ne facebook eshte fjala per vitin e kaluar, e jam duke hulumtuar edhe kete vit ku ka vende qe kan shkolla te mesme dhe nuk u është shpallur vendi i punes, e sa i perket emocioneve sa a me kan pranu mu a jo se pari po ju njoftoj se ju dhe aj komisioni me shkollim nuk me afroheni afer sa i perkeet gjuhes gjermane, sa i perket komisionit ata ta qesin një pytje provokative se qka thot rrogullorja që është shkelje e të drejtës me elementare dhe le ta din qytetaret kete, mu më është thenë keshtu, qka thot udhezimi nr 7 rrëth vetvlersimit, cilat janë kshillat e shkolles, une dua ti them drejtorit te arsimit se nese 90% e qytetarve te drenasit nuk janë qe ti plotesojne ato 3 kriteret qe permenda me heret as une nuk dua te jem zvarranik i dikujt une kurr jo nuk pranoj.

**SADIK TAHIRAJ**-vetem një po ju njoftoj te gjithve se konkursi dhe intervistimi ka qenë publik dhe kanë pas te drejt kushdo me qenë prezent, komisioni ka qenë shumë profesional dhe ka punuar sipas ligjit dhe për secilin kandidat është mbajt edhe proces.

Krytari i komunes-pyti a ka pas te drejt qe ne sallë te jetë edhe dikush tjetër apo vetem kandidati para komisionit

**SADIK TAHIRAJ**-intervistimi ka qenë shumë korrekt prezent kanë qenë edhe sindikata edhe kandidatet e tjere që kanë konkuruar per ate vend pune po kanë pas te drejt edhe antaret e kuvendit vetem te ndegjojnë e jo te nderhyjnë, ne punen e komisionit gjithqka ka qenë transparente:edhe një po e sqaroj se u permend shumë herë se ka msimdhenes me shkolla te mesme neper shkolla kjo nuk qendron, por kemi disa msimdhenes ne msim parashkollar te cilet kanë marrë qertifikata ne qendren dielli ne drenas por per kete qeshtje ju kemi drejtar ministris se arsimit dhe presim pergiigje se si te veprojmë te ju vazhdohet kontrata apo jo dhe për gjithqka do te njoftoheni edhe ju me kohë per kete qeshtje ku janë dikund 38 raste gjithsej

**RIFAT BILALLI**-gjithqka qka kthehet personale nuk ka vlerë, por une po ndalem me teper tek raporti i auditimit që ne fakt ky raport ne vend qe te jet me mirë se sa raporti i vitit 2014 është edhe me me shum vrejteje, por une kisha berë thirrje që keto vrejtje qe janë dhene ne keete vitë, vitin e ardhshem te ketë permirsime se paku 50%, a ka vend per permirsime une mendoj se po, por sa i perket qeshtjes se arsimit qe u diskutua aq shumë unë kisha thenë se më mirë ka qenë te pritet publikimi i listave dhe kishim diskutuar ne një mbledhje tjetër se sa sot qe po diskutojm ende pa u publikuar listat, por një gjë duhet kuptuar te gjith se te gjith ata msimdhenes qe janë me normale dhe jatin mesim kanë mbi 30-vjet pervoje pune as ligji nuk lejon tu shkputet mardhanja e punes, edhe po te garantoj se shum me te perkushtuar janë ata msimdhenes pa keqkuptim duke mos dashur ta lendoj askend sesa disa te rinje qe jatin mësim sot, ka prej te rinjeve shumë te angazhuar po ka edhe prej tyre shumë dembla, sa i perket ketyre parashkolloreve qe drejtori i mahershem e pate hap nje universitet ketu

ne drenas ka qenë një deshirë, por une e kam ditë se nuk ka vlerë,por binduni se puna e ktyre puntoreve ka qenë shumë e mir se kam pas rast kur kam qenë drejtor me punu me dy mesimdheneqe qe kanë qenë shumë te perkushtuara ne ketë drejtim, ligji e rregullon ketë qeshtje por në mungese te stafit perparsi kanë edhe kta që janë duke punuar, bash per kete qellim une kam fol edhe kur kemi nda bursa që bursa tu ipen perparsi atyre qe studiojnë ne ato lemi që kemi mungesë te kuadrit sepse na duhen, gjatë trajnimit te stafit është dashtë te jetë prezent edhe një antar i bordit kete ja kam thene edhe drejtorit,e sa i perket pytjeve nga komisioni per kandidat une edhe vetë kur kam marrë pjese neper komisione kamë kerku qe pytjet per mesimdhene,pytjet per udheheqes dhe pytjet per puntor teknik duhet te jenë te ndryshme dhe profesioneve qe u takojne, ato pytje qe po thua ti se tu kanë drejtuar une mendoj se ato u behen një udheheqesi ndersa pytjet profesionale per mesimdhene ndryshojne , por nese ti mendon se tu ka berë e padrejtë ti ke te drejten e ankeses ankohu

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-veq po ju njoftoj se ky raport i Auditimit është nder raportet me të mira që ka ardh deri me tash dhe është raport pozitiv per komunen e drenasit jo ashtu siq deklaruat ju,sa i perket rekomandimeve rrith prokurimit më të veretet ne kemi probleme me të medha pér shkak se kur po aprovohet buxheti ne po percaktohem dhe po kemi nje list prej 70 der80 projekte,ndersa komunat tjera e bejn nje list prej 10 projekteve jo me teper dhe ketu është ai problemi ,kur ne duhet të shpallim dhe rishpallim një numer të madh të projekteve dhe procedurat marrin kohe,ndersa sa i perket qeshtjes se Arsimit dhe pagesat që jane egzekutu me vendim të gjykatës keto i ka egzekutu thesari dhe ketë problem e kanë gjitha komunat dhe duke krahasuar me komunat tjera komuna jon qëndron më mir,dhe është mir ju që te merrni parasysh reportin e auditorit ne faqen 7 kur thuhet se pasqyrat financiare ne komunen e drenasit pasqyrojn një pamje të drejt dhe reale,e që ky eshte nje konkluzion i pergjithshëm i audidorti të pergjithshem që e ka ber per komunen e drenasit.

**HAMDI KRASNIQI**-I njoftoj të pranishmit se egzekutimin e mjeteve e ka ber thesari e jo ne se stafi është në nivel ketu ne drenas e sa i perket kesaj qeshtje Auditori e ka perdon këtë si keqeklasifikim po kjo nuk është punë e komunes po deklaroj edhe njeher që është qeshtje e thesarit,askush nuk u ndal tek opinjoni i auditorit dhe këtu jane 4 lloje:Opinjon i pamodifikuar,opinjon i modifikuar,opinjon i kualifikuar dhe opinjon i kundert ,ne e kemi te nivelit të lart pozitiv me theksim të qeshtjes,opinjonet e auditorit janë shum më mir se sa opinjonet e auditorve të viteve të kaluar.

**NAIM BAZAJ**- hapi diskutimin pér pikën e pestë të rendit të dites  
5.Raporti finanziar Janar-Qershori 2016

**XHAVIT DRENORI**-unë kem nje pyetje më shum teknike pér drejtorin e financave si dhe nje pyetje per drejtorin e urbanizmit,faqe nr.3 te hyrat vetenake per vitin 2016 si dhe grandet qeveritare vlera e buxhetit 7,047,707.00€

Pyetja e pare ke të bej që kemi te hyra nga burimet vetake 405,953.00€ ndersa per vitin 2015 gjithsej kaqen vlera 200,824.02€ a ke te bej që kemi të hyra dyfish apo qka dua nje sqarim

**HAMI KRANSIQI**-te hyrat e financimit 22.000.00 ka të beje me bartjen e mjeteve nga viti 2015 ndersa 21.000.00 jane të hyra te vitit aktual

**XHAVIT DRENORI**- ndersa sa i perket d.urbanizmit kur e kemi fjalën pér shpenzim dhe ralizim të projekteve deri më tanjane të realizuara 22.69% dhe

mos është pak kjo dhe mos po rreshqasim drejt suficitit dhe mund të mbesin mjetet pa u shpenzuar dhe projektet të mos ralizohen , unë kam informacion nga një firm se gjatë realizimit të projekteve përveq komisioneve për mbikqyrje dhe pranim teknik që paraqesin penges, pengesa ka edhe në fazen e fundit pas përfundimit të projektit se edhe pse puna është kryer edhe aty duhet te ipën para sepse edhe këtu ka zyrtar te korruptuar dhe nuk i lëshojn mjetet per pa dhënë para.

**VEHBI BERISHA**-Unë pata disa vrejtje e sidomos tek kategoria e shpënzimeve përmallra dhe sherbime, fjala është te shpenzimet e karburanteve pikërisht tek zyra e kryetarit ku shoh se ka shpenzime vetem në këtë zyre sa dy drejtori që e kanë punën në teren pra sa drejtoria e urbanizimit dhe ajo e inspeksionit .

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-Sa i përket shpënzimeve përmallra dhe sherbime po ju njoftoj se jemi ndër komunat më të mira në nivel të vendit që kemi shpenzuar më se paku, për këtë merrni raportet e te gjitha komunave ku do të bindeni edhe vetë,

**HAMDI KRASNIQI**-Arsytimi rrëth këtij reporti dhe deklaroj se sa i përket shpënzimeve tek kategoria përmallra dhe shërbime është fakt se jemi ndër komunat që më se paku kemi shpenzuar.

**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin përi piken e gjishtë të rendit të dite

- 6.Propozim vendimet përi ridestinim te mjetete kapitale
- a) Propozim vendim përi ridestinim nga DSHP dhe E
- b) Propozim vendim përi ridestinim nga DUPH
- c) Propozim vendim përi ridestinim nga DSHMS

**VEHBI BERISHA**-pati pyetje:Se qka do të punohët me këto mjete në QMF në Drenas pasi që përi qdo vit ipen mjete por nuk po dihet se qka po punohet me këto mjete,une kisha kerku që keto mjete të shkojn përi ndonje ventilim të rengnit,rregullim të nyjeve sanitare apo të ndonje ashensori per lehonat që do te shkojn ne katin me te lart të objektit.

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-ato që i tha Vehbia ne do të angazhohemi që keto mjete të perdoren aty ku ka nevoj dhe këtë vendim e kemi marr pasi që mjetet e parapara ne Komoran përi renovim të objektit tanë më buxhet që e kemi planifikuar per vitet në vazhdim janë paraparë 100.000.00 euro përi ndertim të objekti të ri.

**SABRIJE KUKAJ**-une kisha kerku që keto mjete të shpenzohen aty ka ka nevoj **XHAVIT DRENORI**-Unë kisha lutë drejtorin e drejtorisë së shendetësis që këto mjete të shpenzohen përi atë qellim që destinohen dhe të mos i vjedhin sepse tri her është ber renovimi i ketij objekti , pasi që lirisht mundë të them se është ndër qendrat me të varfura dhe ketu shkojnë njerzit me te varfer.

**NAIM BAZAJ**- hodhi në votim këtë pik të rendit të dites

Me rastin e votimit prezent ishin 18 anëtar

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:18

Kundër:0

Abstenim:0

**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin përi piken e shtatë të rendit të ditea

7.Propozim vendim përi ndryshimin e rregullorës komunale përi fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së shoqërive tregtare në territorin e komunës së Glogocit

**VEHBI BERISHA**-Sa kanë të drejt që barnatoret kur punojnë në ndrimin e natës ti ngrisin qmimet, kjo është e padrejtë .

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-Kjo rregullore është aprovuar edhe më heret por ka qenë kërkes e disa barnatoreve qe të ndryshojn orarin gjat kohës se veres edhe pse tash është von, dhe nuk ka të bejë me qmim sepse qdo konsumator ka të drejt në qfardo kohe që i merr barnat të kerkoj edhe kuponin fiska dhe ta lajmroj Administraten tatimore.

**NAIM BAZAJ**- pasi që kërkesen e kane ber keta mir është te ju zgjatet orari deri ne oren 22:00 janë 6 kërkesa te ketyre barnatoreve

**XHAVIT DRENORI**- nen 1. Te respektohet orari dhe 2. Që te implementohet kjo rregullore ashtu siq vendoset ne kuvend dhe te mos ndryshojn qmimet mbas ores se orarit te rregullt apo kur janë ne kujdestari

**SKENDER HASI**-Kërkoi qe kjo rregullore të aprovohet pasi që është kërkes e ketyre bizniseve, është fjala për orar dhe kjo deri ne ora 21:00 se në të kunderten mund të prishet momerandumi të cilin e kane nenshkruar për kujdestari gjate nates dhe diteve të vikendit

**NAIM BAZAJ**-Propozoj që orari i barnatoreve te jetë prej orës 9 deri 22, si dhe në këtë rast hodhi në votim këtë pik të rendit të dites:

Me rastin e votimit prezent ishin 18 antarë:

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për: 18 antarë

Kundër: 00

Abstenim: 00

**NAIM BAZAJ**- hapi diskutimin per pikën e tetë te rendit të dites

#### **8.Informatë nga drejtoria e Urbanizmit për banesat prone komunale**

**NAIM BAZAJ**-Në mungesë të drejtorit të urbanizmit unë kisha kërkoi që kjo pik e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe drejtori të na sjell një raportë për të gjitha banesat se kush është në këto banesa dhe të na njoftoj se cilat banesa janë të uzurpuara dhe cilat janë të lira se ne duhet të bejmë diqka me këto banesa.

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-Ne e kemi formuar një komision për verifikimin e ketyre banesave dhe nese banesat janë të uzurpuara ato do ti lirojm sepse ato nuk mund ti mbaj askush pasi që janë pron komunale, por ne duhet ta dijmë se si duhet te veprojm me këto banesa, a do ti japim në shfrytzim, dhe për këtë ne duhet te pergaditemi dhe te vendosim se si të veprojmë.

**XHAVIT DRENORI**-Në duhet me gjetë një zgjidhje dhe duhet ta dijm se mos këto banesa janë duke u keqperdorur .

**SABRIJE KUKAJ**-Unë gjithashtu kërkoi qe këto banesa të u bëhet një zgjidhje dhe të mos keqperdoren nga uzurpuesit.

**LIMAN KRASNSIQI**-Ata që kanë vendim për banesa dihet dhe mund ta dijn të gjithë anatrët e kuvendit por ne duhet të vlersojmë dhe të angazhohemi se si duhet të veprojm në të ardhmen me këto banesa, dhe kërkoi që në mbledhjen e radhës të pergaditëmi dhe të diskutojm për këtë queshtje.

**NAIM BAZAJ**-Gjithashtu kërkoi qe në mbledhjen e radhës të përgaditet drejtori i urbanizmit për këtë queshtje, për të cilin gjë u pajtuan edhe anëtaret tjerë prezent në këtë mbledhje.

**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin për pikën e nent të rendit të dites

#### **9.Zgjedhja e komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe kerkesave të paleve për emërtim të rrugeve**

**XHAVIT DRENORI**-ka qenë e pa evitushme per të formuar një komision për kete qellim, pasi që jemi te vonuar ne kete queshtje,ka qenë një komision i cili

komision e ke kryer punen e vet por nuk është marr per baz,une kam një sygjerim te komisioni që sot po formohet që te kontaktoj dhe të merren per baz kerkesat e qytetarve dhe kryetarve te fshatrave se perndryshe ne do te mbesim duke formuar komisione qdo 2apo 3 muaj se per ndryshe ne nuk mund te vendosim pa pelqimin e qytetarve,se si komision e kemi pas dorzuar një raport me propozime te fshatrave dhe ky komision përseni ka me ardh të ato propozime.

**SABRIJE KUKAJ**-sa i perket kesaj situate ne teren i kemi parapri edhe ne vet duke ju then qytetarve jo keshtu jo ashtu,fakt qe kane qenë dy komisione dhe mund ta pranojm se komisioni i pare nuk ka punuar si duhet sepse disa kryetar te fshatrave jan taku e disa fare nga ana e komisionit dhe fundja fundit ne nuk mund te j'u plotesojm deshirat te gjithëve duhet te dominoj arsyaja dhe duhet të ngritet vëtëdija e qytetarve.

**RIFAT BILALLI**-edhe unë kame qen pjes e atij komisioni një muaj apo një muaj e gjysem dhe ai komison ka pasur per obligim shqyrtimin e ankesave dhe kerkesave te paleve dhe te gjitha ato jane shqyrtu ne sallë më pelqim te kryetarve te fshatrave, rast konkret po permendi Verbocin se qysh i kane pru kerkesat %per % jane ralizu dhe perseri kemi kerkesa dhe ankesa të reja,ne jemi marr vesh qe te vendosim emra të deshmorve dhe figurave që kane dhën kontribut e jo edhe te martirve,ne Shtutic kemi 74 martir dhe binduni që asnje emer prej tyre nuk është vendos ,pastaj kemi rastin tjeter ne Polluzh që me nenshkrim të banorve e kane ndryshuar emrin e një rruge tash kemi kerkes tjeter te re që perseri të ndryshohen emri i asaj rruge

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-ju kisha lut që mos te shkojn ne bazë të deshirave individuale per bazë te merren kerkesa te arsyeshme dhe ato me nenshkrim te lagjeve ,mir është të formohet komisioni dhe atë tre anëtar nga Kuvendi dhe 2 nga egzekutivi dhe shkoni me propozime konkrete U propozuan :

- 1.Rifat Billai
- 2.Sabrije kukaj
- 3.Fatmir Dugolli
- 4.Skender Hasi
- 5.Besart Bajrami

**NAIM BAZAJ**- hodhi në votim propozimet per formimin e ketij komisioni:  
Me rastin e votimit prezant ishin 18 anëtar

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:18


Kundër:0

Abstenim;0

**NAIM BAZAJ**- shpalli të mbyllur këtë seancë rrëth orës 16:30.

Proces mbajtësi


Xhavit Nebihi



Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E DRENASIT  
KUVENDI I KOMUNES



Nr. 06-70970 dt. 22.12.2016

EGLIO GEC

**Mbledhja e rregullt  
Kuvendi Komunal  
23.09.2016**

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më  
dt. 23 dhe 27.09.2016

Mbledhjen e kryesoi **NAIM BAZAJ – Kryesues**

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit  
Komunal ku të pranishëm ishin 30 anëtarë

Kuvendi filloi punimet më këtë :

**Rend dite:**

1. Proces verbali i mbledhjes të dt. 31.08.2016
2. Raport nga Drejtoria e Urbanizmit për qeshtjen e banesave – Pronë  
Komunale
3. Propozim Vendimi i buxhetit të Komunës për vitin 2017 dhe  
parashikimi i buxhetit 2018 -2019
4. ProjektRregullore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin  
2017

*Prezentuan: Kryetari i Komunes z. Nexhat Demaku , perfaqësues te  
KFOR-it, perfaqësues të OSCE-së perfaqësues të mediave si dhe  
qytetarë te Komunës se Drenasit*

Takimi filloi punimet në ora 10 :15

**NAIM BAZAJ** - Shpalli te hapura punimet e kesaj mbledhje i cili i njoftoj te pranishmit me rendin e dites dhe kerkoi nga te pranishmit se a pajtohen me kete rend dite, apo keni ndonje propozim :

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-deklaroj se pika 2 e rendit te dites e cila ka te bejm me raportin per qeshtjen e banesave prone komunale ka hy ne rend dite pa u konsultu fare dhe nuk ka pas nevoj te hy ne rend dite ne paraprakisht duhe te dim se qfar vendimi do te marrim rreth kesaj qeshtje dhe te pregaditemi e pastaj te bim ne kuvend, dhe ne kete rast i propozoj kuvendit qe kjo pik te hiqet nga rendi i dites dhe ne rend ditet te hy propozim vendimi per ndihm Handikosit i cili propozim eshtet i pregaditur dhe i gatshem dhe e kemi mundesin qe t'a shperndajm materjalin

**NAIM BAZAJ**-sa i perket pikes se dyte te rendit te dites ne kete qeshtje e kemi diskutu edhe ne Komitet per Politik dhe Financa po egzekutivi e ka neglizhu kete qeshtje dhe raporti nuk ka ardh ne kuvend qe eshtet dasht te vij dhe te dim se qka po bejm me keto banesa

**SABRIJE KUKAJ**-ka koh qe e kemi diskutu kete qeshtje te banesave eshtet diskutu edhe ne K.P.F-ca kjo eshtet pasuri komunale qe ne nuk thithim asnje cent nga kjo pasuri dhe duhet te konsultohemi me ligjin e ta bejm nje zgjidhje per kete qeshtje,duhet te kemi nje raport te detajuar te dim se qka eshtet pron e jona qka eshtet e uzurpuar qe eshtet e lir dhe ne kete rast une kam nje propozim qe e kam then edhe me heret qe te gjith ato banesa te vogla qe kan mbetur ne atet pjes tu behet nje zgjidhje ketyre banusve dhe te kalojn ne keto banesa te lira te lirohet ajo pjes dhe ka mundesi qe ne ate pjes te ndertohet e jo te mbesim peng

**LIMAN KRASNIQI**-ne kemi kerku nje raport me te zgjeruar dhe me te detajuar se sa banesa janet te lira te dim sakt,ne cilin objekt janet ato, nese ka te uzurpuara kush i shfrytezon ato, keto te dhena duhet ti dim te gjith ne si anetar te kuvendit dhe pastaj te marrim nje vendim se si te veprojm me keto banesa.

**XHAVIT DRENORI**-me te vertet po neglizhohen kerkesat e kuvendit te komunes,ne kemi kerku një raport te detajuar sa i perket prones komunale me qellim qe ato prona te mos keqeperdoren

**VEHBI BERISHA**-une kam qen anetar i keti komisioni me heret e dini edhe ju se nuk kemi mujt te bejm zgjidhje,por sa me heret qe bejm zgjidhje eshtet me mir per ne dhe une kisha mendu te bejm nje komision te perbashket egzekutivi dhe legjislativi, ka ligje konsultohemi edhe me ministri perkatese dhe vendosim diqka.

**RIFAT BILALLI**-te nderuar, kjo eshtet nje seanc me rendesi te madhe dhe ne duhet te punojm shum por para se te hy ne kete tem kam nje deklarat te shkurter, une jam i emruar ne dy komisione dhe kisha kerku nga ju qe komisionet te perkrahen,komision i pare eshtet komisioni per mbikqyrje te projekteve qe me shum eshtet komision monitorues e jo egzekutus ne dalim ne teren po me te vertet projektet nuk kryhen si duhet ne teren punohet pa projekte vetem me paramasa,nuk i permbushin kriteret si duhet dhe ne kete rast kisha kerku nga drejtoria e urbanizmit dhe nga drejtoria e Arsimit te mos leshojn pe gjat ralizimit te ketyre projekteve dhe te ralizohen dhe te kryhen ashtu si duhen,ndersa jam i zgjedhur edhe ne komisionin per emertim te rrugeve qe kemi shum kerkesa dhe ankesa sa i perket kesaj qeshtje,une kisha pas nje kerkes qe ata te cilet bejn kerkes per ndryshim apo emertim te nje rruge

dhe japin propozime të ipet një biografi per ata të cilet propozohen të dihet sakt se për kend po behet fjal dhe të mos vine propozim të pa arsyshme dhe në këtë rast kisha kerku ndihm nga ju se ka kerkesa që ne një fshat psh.të hiqet emeri i Ilaz Kodres e të vendoset një emer tjeter e që mu me doket shum e pa arsyshme,shum her mendoj se ketu Kryetari mir e kishte pas që ka propozu që rruget te jenë me numra e jo me emra,ndersa tash po ndal të qeshtje e banesave që janë prone komunale ketu duhet te jemi shum te kujdeshem dhe të mos bejm leshime ,ne e dim shum mire si kuvend se kujt ju ka nda banesa e kujt jo dhe kisha kerku ne kete rast që kjo qeshtje te zgjidhet sa me par dhe në mbledhjen e radhes të kemi një raport ma konkret të dim sakt se kush është ne ato banesa,nese ka usurpues të largohen po ne duhet te dim se sa lokale afariste ka ne ato objekt dhe kush i shfrytezon ato.

**NAIM BAZAJ**-gjithashtu kerkoj që të dihet sakt për qështjen e ketyre banesav sepse ne e dim që aty ka usurpues.

**IDRIZ HYSENAJ**-banesat që jon dhan me koncesion për 99 vite dhe janë kthyer ne 45 vite ka krijuar një problem te madh ne mes nesh dhe blersve,është ndrru kjo kontrat dhe po ju njoftoj se keto banesa jan ne ajer dhe per kete rast lenda eshte ne gjykat dhe nuk kemi qka te diskutojm per kete qeshtje dhe nuk mund te merret asnjë vendim per pa u kthy vendimi siq ka qen me heret dhe per kete rast e fajësoj komunen se nuk është dasht të bez këtë veprim

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-po ju njoftoj se kete nuk e ka ber komuna po agjensioni kadastral

**LIMAN KRASNIQI**-pati verejtje ne këtë rast dhe deklaroj se kontrata e nënshkruar nuk guxon të nderrohet është e paligjëshme kjo

**ISTREF ELSHANI** – duhet me dit një gje se prona është gjithëher e komunes po nese kontrata eshte e nenhkruar per 99 vite edhe une mendoj se kjo kontrat nuk guxon të ndryshohet

**BETIM BERISHA**-une e kam formu një komision per me veretetu gjendjen faktike të ketyre banesave dhe mbledhjen e kaluar e keni pas një Informat, dhe ju kemi njoftuar per secilen banes se sa komuna ka prone te veten, ne do të pregaditemi që keto banesa ti japin ne shfrytezim dhe kisha kerku që të shtyhet per mbledhjen radhes dhe ta pregadisim një raport ashtu siq po kerkohet nga kuvendi,banesat janë të lira dhe nuk janë duke u keqperdonë si të vendoseni ju ne do ta respektojm atë vendim me u shite nuk mundën vetem mund të ipen në shfrytezim.

**IDRIZ HYSENAJ**-pati pyetje: se si jane dhene banesa në shfrytezim te perhershëm ne Poklek pse atje paskan drejt e ketu jo?dhe kisha kerku që sa me par te merret një vendim dhe te behet diqka me keto banesa sepse per dit po usurpohen banesa,t ne banesat ku jane pron e rukollit ato jan te usurpuara te gjitha e nuk eshte mir.

**NAIM BAZAJ**-kerkoj që ne mbledhjen e radhes te vije një raport i detajuar dhe kerkoj që kjo pik e rendit te dites të shtyhet per mbledhjen e radhes dhe ne kete rast hodhi ne votim rendin e dites me ndryshime që ne vend te Raportit per banesa te hy ne rend dite Propozim vendimi per Handikosin

Me rastin e votimit prezent ishin 25 anëtar

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:25

Kundër:0

Abstenim:0

**NAIM BAZAJ**- hapi diskutimin per piken e pare te rendit të dites

**XHAVIT DRENORI**-pati verejtje te faqja nr.6 tek fjalimi im ne fund te fjalimit ku është shkruajtur se une mashkull nuk jam femer kete nuk e kam thënë dhe kerkoj që kjo fjal te hiqet

**NAIM BAZAJ-** hodhi ne votim këtë pik te rendit te dites me ndryshime  
Me rastin e votimit prezent ishin 25 anëtar  
Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:25

Kunder:0

Abstenim:0

**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin për piken e dyte të rendit të dites

### **2. Propozim vendim per Handikos**

Pasi që nuk pati verejtje dhe diskutime per këtë pik të rendit të dites

**NAIM BAZAJ**-hodhi në votim këtë pik të rendit të dites

Me rastin e votimit prezent ishin 20 anëtar

Rezultati i votimit ishte si vijon;

Për:20

Kundër:0

Abstenim:0

**NAIM BAZAJ**- hapi diskutimin për piken e tretë të rendit të dites

### **3. Propozim Vendimi i buxhetit të Komunës për vitin 2017 dhe parashikimi i buxhetit 2018 -2019**

**HAMDI KRASNIQI**-dha nje arsyetim rrith Vendimi te buxhetit te Komunes per vitin 2017 dhe parashikimi i buxhetit 2018 -2019 dhe ne kete rast i njoftoj anetaret e kuvenit me procedurat e zhvillimit qe nga muaji maj e deri ne kerkesat finale dhe ne kete rast kerkoi nga te pranishmit qe ky buxhet i propozuar nga kryetari i komunes te votohet pasi qe ne jemi te pregaditur dhe gjithqka kemi barazuar ne kohë.

**VEHBI BERISHA**-e ndegjova me vemendje Drejtorin e kamë shtjelluar ketë propozim vendim te buxhetit për vitin 2017 por une kisha kerku qe mos leshohen gabime sikurse viteve tjera qe na ka ndodh, por ne kete rast kemi edhe sygjerime, sidomos tek lista e projekteve kapitale qe une e kam permend edhe me heret një rast qe ne kete vite eshtë pak vone, por une kisha kerku viteve tjera kur te caktohet projekti i ndertimit te një rruge apo e kanalizimit te dihet me emer seer cilen rrugë bëhet fjalë, pasi qe tash edhe emertimi i rrugve dihet, qe te dihet saktesisht se për cilen rruge po behet fjal si ne qe jemi anëtar te kuven po ashtu le ta dinë edhe qytetaret, sa i perket listes te projekteve kapitale me vjen mir qe jane perfshi fshatrat si: Gradic, Godanc, Shtuticë e fshatra te tjera per rrith pasi qe po behet infrastruktura, dhe shpresojm se nuk do te kem migrim ne te ardhmen nga keto fshatra ne qytet ku për shkak te kushteve shum prej tyre kan migruar, por unë do te ndalem te një projekt qe ka shum vite qe ka filluar dhe eshtë fjala për ndertimin e ujësjellsit ne Kamenicë ku perfshihet një numer i madh i fshatrave dhe ende nuk po shoh se ka diqka konkrete dhe ne kete rast une kisha pas deshir te di se a eshtë serioz ndertimi i ketij projekti, pasi qe 10 fshatra presin nga ky projekt a kanë qëllim donatoret qe te ralizojne kete projekt apo perseri do te shkoj si viteve tjera, dhe ka dy mandate qe parashihet ndertimi i ketij projekti por nuk po perfundon, me vjen mir edhe ndertimi i rruges ne lagjen Gashani ne Terstenik qe me te vertet ka nevoj, si dhe me intereson te di për ndertimin e kanalizimit ne Gllanasellë ku perfshihen Lagja Berisha, Maloku, Bunjaku, por ti e din drejtor se Lagja Mehani, dihet se janë ta parapara 30.000 euro por edhe pse perfshihet lagja Berisha ne

fakt nuk ka mundesi të lidhen në këtë rrejt të kanalizimit dhe nuk mund të lidhen në këtë kanalizim edhe një pjes e lagjes Lladroci, një pjes e lagjes kurrumeli e as lagja Mehani se kjo shume sipas mendimit tim eshte shum e vogel për tu ralizuar ky projekt,pastaj me gezon fakti per ndertimin dhe asfaltimin rruges ne Sankoc që ka qenë e nevojshme pasi që atje ka qen rruga vetem me zhavor,une kisha propozu që per projektin per hartimin e planit lokal te veprimit ne mjedis te ndahen 10.000 euro dhe keto mjete të merren nga projekti Hartimi i planit të veprimit për energji të qendrushme KK Drenas qe është projekt e që janë të parapara 20.000 euro,ndersa sa i përket projektit ne drejtorin e sherbimeve publike me gezon fakti se me të vertet ëshë e nevojshem dhe projekt shum i arsyshme është fjala per shpenzimet e vorrimit si dhe nje pyetje per drejtorin e Administrates se a është parapar buxhet për 5 punetoret teknik të komunes se drenasit kur dihet se ne kemi marrë nje vendim që keta punetor të kthehen me buxhet te komunes.

**SOKOL BYLYKBASHI**-sa i përket draft buxhetit të komunes tone une shoh se keto jane politka të pa drejta dhe të pa arsyshme sa i përket hartimit të ketij buxheti,per me qen nje buxheti i mir une mendoj se duhet ti kete tri tipare:që buxheti të jete gjithëperfshiers, i balancuar dhe fleksibil dhe pse ne jemi në këtë gjendje jane dy qeshtje si : e para është si ndahet ky buxhet dhe se si shpenzohet,sa i përket listes se projekteve kapitale une shoh ketu se ka qasje selektive dhe perjashtuse edhe ne këtë draft buxhet si po permendi i kemi dy fshatra që nuk janë perfshi ne këtë list si Damaneku dhe Vuqaku si dhe fshati Likoshan ka të ndara vetem 20.000 euro dhe është krahasu me disa fshatra si Qikatov e re dhe poklek i ri a ne fakt ky fshat ka nevoj shum per investime,si dhe kam verejtje ne atë që është parapar blerja e nje vture ne drejtorin e Financave ne vler 15.000 euro që është shumë e madhe, dhe lluks i madh, shumë ma e arsyshme do te ishte të investohet ne shëndetsi si ne Komoran apo ne Terstenik apo ndonje aparatur që është e nevojshme për kete qëllim,kur jemi të investimet kapitale sa i përket projektit per ndihm skamnorve kjo shume është pak ne krahasim me gjendjen që ka popullata ne komunen tonë,ndersa vlera e mjeteve të parapara për mbykqyrjen e projekteve kapitale ne vler prej 30.000 euro nese janë per organin mbikqyres janë teper, edhe ashtu kur dihet se punen nuk e kryni si duhet,ndersa sa i përket planifikimit te Mallrat dhe Sherbime po permendi zyren e kryetarit që janë të parapara 26.000 euro,keto mjete janë shume dhe me tendenc, kur dihet se ne vitin e ardhëshme mbahen zgjedhjet, dhe ne kete rast une kisha propozu që 16.000 euro të hiqen sepse nuk i duhet gjith keto mjete zyres së kryetarit,e nga kjo kategori per mallra dhe sherbime është dasht të perkrahet dhe të kete mjete me shume drejtoria për shëndetsi dhe mirqenje sociale që ju kishin dasht për barrna esenciale dhe materjal shpenzues, e jo popullata të shkojn në ordinanca private.

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**- deklaroj se ne kete drejtori jon të parapara 220.000 euro e jo siq po deklaroni ju.

**LIMAN KRASNIQI**-ne bazë te shperndarjes se buxhetit mendoj se eshte e arsyshme dhe I ka perfshi te gjitha fshatrat me nevoj.kisha propozu që nga riparimi dhe rindertimi i kanalizimeve ne komunene e drenasit 20 mijë euro te kalojnë per kanalizim në komoran III pasi që per mirëmbajtje jte kanalizimeve janë te parapara edhe 45.000 mijë euro ne DSHP,janë shume pas qe ne e dim qe kanalizimet ne komunen tona janë të ndertuar ne 5 vitet e fundit ,kisha kerku që ti bashkangjinat atij projekti dhe i kisha propozu d.urbanizmit që kanalizimet që jonë në vazhdimsi të kenë parasysh që të fillojn prej gropes

septike e jo të krijojnë deponi pran institucioneve te rregullimi i deponive të ceket se cila deponi pasi që po kemi problem sidomos me mbeturinat inerte kur dihen se ne ne kuvend e kemi marr një vendim per lokacion per meturina inerte, kisha propozu që egzekutivi ti propozoj kuvendit për menyren e funksionalizimit të asaj deponie ose të kerkohet të shqyrtohet mundesia që ajo deponi ti ipet dikujt ne shfrytezim që ta pagujn. Te renovimi i ndriqimit publik me sistemin inteleqjent të komandimit me llampa ,une kisha propozu që keto mjete të shkojn që të zgjerohet ndriqimi ,ku kemi shum lagje edhe shum rruge pa ndriqim si kemi komoranin që fare ska ndriqim. Te ndertimi i kapacitetit te ujesjellsit ne kamenic -drenas ky eshte donator i fundit ne kete vit ne komunen tone edhe është nje investim me vler të madhe per komunen tone ,tuj e pas parasysh se prej ketij kuvendi disa vite radhazi kemi nda mjete financiare për Kamenicë per rezervare dhe per rrjete të uje sjellsit ,kisha kërku nga komisioni nivel të kuvendit që është per vlersime dhe përcjellje e punimeve ne teren që të dal ne kete lokacion edhe te kerkoj nga d.urbanizmit dhe zyra e prokurimit që ta bej verifikimin e puneve të egzekutuara deri me tash,se sipas raportimit të puneve, kryesit pran CDIS thuhet se rezervari nuk ka kapacitetin e ofertuar është i pa perdorshem, dhe nje pjes e gypit fare nuk është i egzekutum egzistojn vetem pusetat e ujit dhe te na bien nje Raport për punet e kryera e pastaj te fillohet me implementimin .

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU-** keto 100 mijë euro -nese nuk gabon- janë në baz të momerandumit që e kemi nenshkru me donator edhe ky projekt që po investohet në uje sjells për 12 fshatra me sa e di unë keto mjete janë per pompat e ujit,ndersa puna në teren kryhet nga donatori.

**SABRIJE KUKAJ** -une kisha propozu që të renovimi i shkollave ti hiqen 5.000 mijë dhe 10.000 mijë që janë për rrrethoje ne Polluzhë keto mjete të shkonë për nxemje ne shkollen Shaban Polluna në Polluzhë, kisha propozu që te merren nga drejtorian per kultur ,rini dhe sport nga subvencionet te merren 10.000mijë euro dhe të shkonj ne d,arsimit dhe te behen 30.000 mijë euro subvencione thjesht e kam qeshtjen per studentë , të rregullimi dhe asfaltimi i rruges lagja Tiku ,Dobra që është projekt 40.000 mijë euro dhe 30.000mijë euro te lagja Gashani kisha propozo që lagja Dobra nuk e kane gjendje keq dhe 40.000 mijë euro dhe 30mijë te behen bashk dhe të shkojn në Lagjen Tiku dhe Gashani dhe keto dy lagje kryhen me 70.000 mijë euro

**XHAVIT DRENORI**-me vjen mire që ky vendim sot që na ka ardhe neve ketu ëshë më i harmonizuar dhe i balancuar ka pasur trasparencë dhe une shpresoj se edhe ministria do të njeh këtë vendim dhe nuk do të na dalin telashe sikurse vitin e kaluar dhe në këtë rast une kisha kerkuar disa sqarime ne disa dikaster të caktuar fillimisht po ndalem të drejtoria për pronë dhe kataster dhe kamë një pyetje për projektin për shpronsime ku janë të ndara 100.000mijë euro dhe në këtë rast une kisha pasur deshir të di se a përfshihen në këtë projekt edhe fshatrat Qikatov e vjeter dhe Dobroshec ku është ndertuar rruga dhe nuk janë paguar pronaret

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**-po në këtë projekt përfshihen edhe keto dy fshatra

**XHAVIT DRENORI**-sqarimi tjeter me intereson të di ne drejtorin për Kultur,Rini dhe Sport ne vend që të orjento hemi kah rinia dhe kultura dhe të kemi nje vend ku të drejtohet rinia ne më shum jemi drejtar kah sporti une e perkrahu sportin edhe e dua shume ,po po me doket pak vlore e madhe si: janë nda 150.000mijë euro për ndertim të stadiumit,40.000mijë euro kemi

subvencione që komuna i ndan çdo vit gjithsejt jane dikun 200.000 mijë euro atëher ku po mbesin klubet tjera, rast konkret e kemi klubin e Fucallit, "Feniksi" që prej pranimit në uefa është i vetmi klub që na perfaqëson në nivel vendi dhe të ndahen vetem 2.000 euro une këtu shoh se është një diferencë e madhe dhe nuk ka balancim ne ndarjen e buxhetit.

Shqetësimi tjeter kam se assetet komunale mund të keqëperdoren rast konkret e kam fjalën përfushen sintetike të ndertuar dhe nuk kemi hartuar asnjë rrgulllore pasi që është prone komunale dhe ne kete rast kete fushë e shfrytezon feronikli dhe femijeve tanë u merren pare kur i kryen keto ushtrime ne kete fushë dhe më doket jo e drejt.

**KRYETARI I KOMUNES-NEXHAT DEMAKU**- po ju njoftoj që gjithat mjete që paguhen nga nxënësit aty paguajn per trajner se ata duhet më pas nje pagë dhe nese nuk gaboj janë dikun 7 apo 8 trajner që punojnë më grupe moshat e ndryshme në klubin feroniklit, dhe gjitha keto pagesa behet përmes gjillollogarise dhe keto pagesa shkojn per klubin e nuk mund të keqëperdoren por une mendoj se ma mirë ka qenë që me nje vendim ky stadion ti ipet ne shfrytezim feroniklit per nje periudhe 3 apo 4 vite dhe aty ka mundesi të punësohen 3 apo 4 punëtor se ma veshtir është me menagju tash dhe më mirembajt se sa që është ndertu dhe nuk guxojmë ta lëmë në atë gjendje.

**DORUNTINA BUNJAKU**- projekt që është ndertimi dhe asfaltimi i rruges ne Gllanaselle është projekt i pa emruar dhe kisha propozu që ky projekt të shkoje per rrugen kah lapidari i Fehmi Lladrovcit ne Gllanaselle.

**RIFAT BILALLI**-per me qen projektet si duhet dhe të pa gabushme atëher stafi i drejtoris se urbanizmit është dashtë me dal ne teren edhe me pa gjendjen faktike, ne kete nuk e kemi kerku vetëm sivjet por qdo viti por kurr njeher nuk është ber kjo, keto parashikime bahan ne bazë të kerkesave ose qysh i ka lidhjet njeri edhe ne atë menyr shkon, kamë verejtje të projektet kapitale kurr njeher nuk ka pasur ndryshime qdo her te fundit kanë qendru te fundit, dhe të paret qdo her te paret, duhet me pas levizje te projekteve në listë me dal edhe ne pjesen e pare jo qdo her me ndejt ne pjesen e fundit se shume projekte që po janë me te hyra vetanake po mbesin pa u realizu, fshati Shtuticë ju e dini që tri vite e kemi parapa ka 50 mij euro per rrugen kryesore Polluzhe- Dashec asnjë cent kurr nuk është shfrytezu parashihen e nuk shfrytezohen thjesht veq me qen ne leter a raliteti askund, edhe ne Sankoc nuk është gjendja e mire kam qen edhe ne disa lagje te llapushnikut edhe atje ishte gjendja shum e rand, atje me traktor spo u kalojke e leje me me vetur dhe kisha kekru që te behet nje rrotacion se jo qdo her dikush te hy me te hyra vetanake e dikush drejtperdrejt nga ministria e dikush fare asnjeher nuk jam me i barazu nje fshat që është me numer me te vogel te banorve me ata që është me numer me te madhe të banorve. Sabria e permendi projektin per nxemje ne Polluzhë po të kisha qenë drejtor nuk do të kisha parapa nxemje per shkolla pa u paise me mjete te kompjuterizmit, une e perkrahу propozimin e sabris në qoft se nuk i demtojn projektet që ju hjejet nje sasi e te hollave nga ato projekt edhe pse besoj që kryhet me ato mjete pasi që nuk kane siperfaqe shum te madhe, nuk besoj që e ka ndonje shkoll gjendjen me keq se rrrethoja te shkolla Deshmoret e forteses ne Verboc nuk është parapa per ama besoj që vitin tjeter po.

**IDRIZ HYSENAJ** -ato projekte te cilat janë propozu janë hy ne planifikim te buxhetit kisha dash me i pyet drejtorat se a kane kod edhe nese qaj kod nuk ralizohet qka behet me ta ato mjete kush po i merr ku po shkojn ne cilin projekt ku po i destinojn, ky kuvend merr vendim a fatkeqsisht ato nuk ralizohen, qysh

mundet me marr vendim ne kuvend edhe mos me u ralizu ai projekt dhe me u nderru destinacioni .kuvendi thjesht nje formalitet e nese kuvend është organi më i latrë atehher duhet me u ralizu, nese jo dikush duhet me jap perjegjesi.une kam raste qe ne shtator te viti 2014 është marr vendim pëe asfaltimin e rruges lagjen Tahiraj nuk është kry ,ne vitin 2015 ka pas me u kry nuk është kry, dhe tash ne vit 20016 është si propozim dhe e di që nuk ka me u kry.Në Abri asnje lagje nuk ka rrugë,kanalizim dhe uje sjells kamë kerku vitn e kaluar kanë hy ne proces është marr vendim dhe jane definu edhe cilat lagje kan me u shtru nuk janë kry,ne lagjen Tahiraj asnje investim nuk është ba as rruge ,kanalizim, ujesjells janë dikund 80 shtepi, po me doket e kote me propozu se i pelqen dikujt si pelqen nuk e ralizon kisha kerku nga ju Kryetar dhe Kryesues të ralizohen  
nuk e di per qka jemi ne ketu

**BUJAR THAQI**-te dim që ne parim se miratimi i buxhetit është një qeshtje shum e rendesishme dhe shumë problematike tuj i marr parasysh kerkesat e fshtrave,qka mu me doket shum shqetesuese është se ne fshatra tonë nuk pyesin as administrator as perfaqesuesin ne kuvendin komunal se ne cilen lagje me me ndertu ate rruge apo kanalizim,une kam propozim per fshatin Llapushnik qe projekti kanalizimi i ujrate te zeba të shkoj në lagjen Lugu

**HAKA TAHIRAJ**-me propozimin qe e dha Bujar Thaqi nuk pajtohna as une jo kanalizim po ne ate pjes të asaj lagje nuk është investuar asgje,aty ja vlen me investu edhe më shum e jo me hjek edhe ato investime qe i kanë se ky fshat ka nevoj me intervenu më shum e jo qeto dy projekte që janë edhe qeto dyja me ja hjek,ne si komision kemi qen ne atë pjes dhe me te vertet nje gjendje shum e rand.

**FATMIR DUGOLLI**-ky buxhet krahasuar me vitin e kaluar është ma i balancuar dhe ma gjith përfshire,une kisha propozu që pasi që ne kete buxhet nuk është perfshi Damanaku dhe Vuqaku ti perfshim edhe keto dy fshatra me ndonje projekt,ne duhet me marrim nje qendrim se projektet që shkojn me grande po janë te garantuara e disa projekte që kane qen me te hyra vetanake jonë shty edhe nuk janë ralizu,ka fshat që dy vite jonë mbet me te hyra vetanake ose jon ralizu pjeserisht,ne duhet te dim se cilat projekte po i lame me grande dhe cilat me te hyra vetanake nese nje fshat është me dy projekte atehher nuk mundet me qenë te dy projekte me te hyra vetanake,une mendoj se ne si kuvend duhet me i marr kompetencat tonë që i kemi ne dor edhe me vendos se cilat projekte shkojn me grande e cilat më të hyra vetanake dhe ralizimi dhe mos ndryshimi i projektit se kemi pas raste që dhe jonë ndryshu projektet,propozim tjeter kam qe projektet që janë me te hyra vetanake e nuk mujnë me u ralizu për shkak të mos grumbullimit e të hyrave vetanake të kanë prioritet në vitin e ardhëshme që ato projekte me qenë prioritet jo me mbet te fundit,ne kete vit nuk kemi parapa kurgja për rregullim të lumi ku ne disa zona ku po rrezikohetjeta edhe pasuria e njerzve kur po ka vershime,dhe sa i perket ndarjes se buxhetit per Nekoc te projekti për kanalizim me u shtu mjetet se 20.000 euro janë pak.

**NAIM BAZAJ**-projektet kapitale që janë per vitin 2016 e nuk ralizohen të janë prioritet per vitin 2017 me grande.

**SABRIJE KUKAJ**-une kamë propozim nuk po du me i hjek prej drejtoris sherbimeve publike po te merren në projektin mirëmbajtja e kanalizimit lokal atmosferik janë 45.000 euro dhe nje pjes e tyre mjeteve të shkojn të rregullimi i varrezat pasi që 30.000 euro janë pak

**HYRIJE XHEMAJLI**- te kanalizimi ne kemi ban kontrat sivjet dhe ajo kontrat është 3 vjeqare

**XHAVIT DRENORI**-po du me i prek tri qeshtje.une mendoj se tek projekti i uje sjellsit që është t'uj u ralizu me ngrit një komision ne kuader të kuvendi komunal dhe ne me dal edhe me monitoru qatë pune sepse projekti i uje sjellsit është ma vitale për qytetaret që kanë nevoj, dhe kur e kamë pyetur kompanin që është t'uj i mbikqyr me ka thanë se komuna juaj nuk po na jepë asnje anëtar në komision për mbyqyrje kjo do te thote se komuna jonë ka ndejt krejt anash,ku qytetaret po dergojn fotografi ku gypi mbulohet me gure,une lypi paramasa a drejtori e urbanizmit thote se ne nuk i kemi shkon të kompania,a është tuj investu ne drenas a po ku është tuj investu ajo kompani këtu ka vend për manipulim, dhe ne duhet me dit se a kanë me u shfrytezu gypat që jonë ne dhe a jo qetë informat nuk po ma jepë askush,une nuk muj me dal si komision pa pasur dokumentacion qofte edhe vikendeve edhe me vetura private,ujet më i shku nje familjes që nuk ka dhe është mbetë me bunare ajo është pasuria me e madhe për atë familje,e dyta të qeshtje e Arsimit duhet më u banë një planifikim i mir mos me na ndodhë ma keqëmenagjim me kontrata dhe me u denu komuna dhe në këtë vite jane pranu 3 mesimdhënsa me shkolla të mesme, bile bile per nja 30 vetë kanë apliku ku 25 kanë qen me fakultet e 5 prej tyre kanë qen studenta me diploma te mesme dhe ështe perzgjedh pikerish ajo aksidentalish ka ndodh me pase mbiemrin Demaku.

**AJET DEMIRI**-duke pas parasysh kerkesat e qytetarve për investime kapitale nëper fshatrat e tyre,ketu ka dal se e kemi nje list bajagi të madhe të projekteve jane mbi 126 projekte kapitale edhe eshtë mir se të gjitha fshatrat jone perfshi me nga nje projekt ketu ka probleme me ralizimin e tyre ne zyren e prokurimit sa i perket pregaditjes së proceseve te tenderimit dhe lidhjen e kontratave sepse është numer shum i madh i projekteve ,dhe ky numer i madh i projekteve paraqen vonesa ne ralizimin e projekteve ,mbetje buxhetore sepse nga keto projekte vetem nga 1.000 euro me mbetë 126.000 euro shkojn suficit.

Të fshati Nekoc është vete projekti asfaltimi i rruges në fshatin nekoc pa caktuar lagje se ku do te behet ky projekt,une kisha propozu që ky projekt të jete lagjia Plakaj dhe lagjia Lugu,kame edhe nje kerkes në drejtorin e Arsimit duke dit se vitin e kaluar ka ndertu nje teren sportiv në shkollen tone mirpo në atë shkoll nuk është e ndertuar edhe rrrethoja e shkolles,kisha kerku nga kjo drejtori që ta futë ne projekt edhe rrrethojen e kesaj shkolle dhe nese eshtë e lejushme që keto mjete të merren në inventarizimi i shkollave ne drenas te merren 4,791 euro

**ISTREF ELSHANI**- të projektet kapitale per vitin 2017 po lidhem te fshati Krajkove ,me heret e kemi pas banë nje plan projekt dhe i kemi pas nda nja 20.000 mijë euro per trotuar edhe ata ne kuader te kesaj se ekemi bane nja 4.000 mijë euro per nje projekt 4 kl trotuare po sjemi thuj thane me banë trotuar 4 kl po per 1 kl ajo është nje nevoj shumë pasi që femijet kalojne ,une nuk e di pse i kane hjek ato 20.000 mijë euro por une kisha kërku që ato 20.000mije euro me u kthy edhe me e mbeshtet nje trotuar per te cilën mendoj që edhe ne kemi participu ne atë pjes dhe i kemi pagu 4.000mije euro si fshat dhe ato mjete ku me i marrë ne fshatin Baice jone 50.000mije te merren 5.000 mijë, ne Terstenik jone 50.000 mijë me i marrë 5.000 mijë,ne Vasileve jone 50.000 mijë me i marre 5.000 mijë dhe ne fshati Zabel i ulet jonë 60.000mije me i marrë 5.000 mijë dhe kjo shume prej 20 mijë euro të shkojne ne Krajkove per trotuare.

**NAIM BAZAJ-** une kisha propozu që 10.000 euro ti merren Vasileve dhe 10.000 zabelit te ulet dhe te shkojn per trotuar ne Krajkov

**RIFAT BILALLI-** une kam nje propozim ndoshta ne kete vit nuk kemi mundesi po që ju ipet ndonje mundesi te ngritet nje lapidare perkujtimore të Shavarinat por jo vetam atje po te nisem gradualish ne qdo vend .

**SOKOL KRASNIQI-** po ndalem te projektet kapitale,te ndertimi i infrastruktures asfaltim me kupëza ne drenas,eshte mir që ky projekt me shku ne rrugen Gani Elshani është mir me u precizu, fillimisht me shku andej e pjes tjera kupëza apo asfaltim më vazhdu në rrugë tjeta

**IDRIZ HYSENAJ-** ne llapushnik lagjja Qupaj e kane një asfaltim i rruges,lagjia tahiraj ketu duhet të jete tahiraj edhe gashi se jone dy lagje pastaj lagjia tahiraj dhe haxhiaj keto dy lagje nuk kane lidhshmeri njera me tjetren, te kanalizimi duhet të jete se vitin e kaluar ka hy ne projekt po nuk është finance as kanalizimi e as rruga ne kete vite është hy si projekt edhe po doni me hifik ,vitin e kaluar nga llapushniku ka shkuar ne Poterrk prap sivjet po don ashtu me vepru,jemi tuj e ban nje shkelje tuj i diskriminu ata qytetar se deri ma tash asnje investim nuk është ber ne ato dy lagje ,te lagjia tahiraj dhe gashi keto dy lagje lidhen me nje rrugë edhe kanalizim që kane me u lidhe, ne Abri nuk është kufizu aszgjë është projekt kanalizim ne Apri te eperme,Abria i ka dikun 7 lagje as nuk është precizu se ne cilen lagje kanë më shku edhe rruge edhe lagje nuk është precizu ne në projekt e kemi pas edhe nje trotuar ujë ska,kanalizim ska ,rruge ska.

**BUJAR THAQI-** ajo qe foli kolegu kurgj skemi personale amo mos u perzi ti ne Llapushnik ,une jome asambleist dhe nënkyrjetar i keti fshati dhe kerkoi nga Kryesuesi që propozimi im të hidhet ne votim

**NAIM BAZAJ-** hodhi ne votim projektin per kanalizimi i ujrave te zeza ne llapushnik lagjia tahiraj ashtu siq e ka pregadit egzekutive kur vetem 5 prej tyre ishin Per, ndersa propozimi i Bujat Thaqit ishte që ky projekt të shkoj në lagjen Lugu ku u hodhë në votim dhe kaloj me shumic votash

**RIFAT BILALLI**-une ju kisha sygjeru që të mos merremi me lagje ne jemi perfaqësues të gjithëve, une kam pas propozim edhe me heret dhe perseripo e them se për me u caktu projektet se kush ka nevoj une kisha kerku që të dal nje komision ne teren dhe të sheh gjendjen faktike,une vet e kamë vizitu kete lagje ne llapushnik dhe binduni se as me traktor nuk mundet me kalu e leje ma me vetur dhe ne kete rast kisha kerku nga bujari që të terhiqet nga ky propozim dhe të mbeten mjetet ashtu si janë parapar, se edhe per ju kjo është me mir edhe kesisoj i fiton votat edhe njerzit, nga njeher duhet mu sakrifiku dhe une vete kam vepru kesisoj ka pas me u ndertu rruga deri ne lagjen time por kam kerku nga drejtoria e urbanizimit që ato mjete të shfrytezohen ne dy lagje tjeta ne kete fshat

**NAIM BAZAJ-** propozoj që projekti per kanalizim ne lagjen Lugu të mbesin 20.000 mijë euro dhe 10.000 mijë që mbesin dhe 10.000 mijë ti marrim nga hartimi i projekteve zabituse nga komuna dhe keto 20.000 mijë euro te shkojne per kanalizim ne llapushnik lagjia Tahiraj

**SOKOL BYLYKBASHI** - tuj e pasë parasysh verejtjet dhe kritikat që i dhash me heret dhe ky buxhet po deshmohet se është buxhet I pazareve dhe me ndikim e jo i qytetrave që kane halle dhe ne nuk do të marrim pjesë ne votim

**SABRIJE KUKAJ**-ne në K.P.F -ca kemi punuar 4-5 mbledhje dhe i kemi pa priorititet dhe në baz të prioriteteve dhe kemi vepru dhe nese dikush don me ban ndryshime lete del me propozim konkret se ku po don me e hjeke ata

projet edhe letejep nje aryetim pse po don atë projekt qofte rruge apo kanalizim po don me qite ne lagje ne nuk mundemi me coptu buxhetin per hater të askujt po letejet ashtu siq e kapru K.P.F-ca per llapushnik

**IDRIZ HYSENAJ-** nje e drejt smundet ti mohoet askujt se pse të gjith jemi të barabart,por kjo ka ndodh pikerisht në këtë fshat dhe në keto lagje të Llapushnikut ku asnje kaci zall apo diqka nuk është investuar në këto lagje,gjendja është shum e keqe në ato lagje dhe fajin për gjith kete e ka Kryetari dhe Drejtorat,ne duhet ti mbrojm interesat e gjith qytetarve të drenasit e pikerish ato lagje pasi që ato kanë qene bazat e para te UÇK-së dhe qdo shtepi aty ka qenë UÇK,edhe vitin e kaluar kanë qenë te planifikuar dhe ka hy ne list projekti për keto lagje po nuk është investu prej liste e ka hjek Kryetari dhe drejtorii urbanizmit prandaj nuk është mir kjo.

**SOKOL BYLYKBASHI**-siq e dine në mbledhjen e kaluar kam folur për parimet e përpilimit të nje buxheti të mir por sigurisht nuk janë marrë per bazë sygjerimet dhe verejtjet e mia,mirëpo sot do te flas per disa projektet kapitale dhe sherbimeve publike që kane nje natyr të ndjeshme dhe emergjente,fillimisht do të flas për tri mbikalime që ka nevoj komuna e drenasit dhe që janë emergjente nje mbikalim në afer stacionit të trenit,nje mbikalim ne zabel dhe nje në Arllat ku dihet që ne keto vende kalojn qdo dite nxenesit ku kan marrur edhe jete semijeve,nese nuk kemi buxhet per keto tri mbikalime se paku me banë kerkesa ose edhe presione ne Ministri e infrastrukture dhe te D.financave.ne drejtorin e sherbimeve publike e pashe që per intervenime emergjente janë të parapara vetem 10.000mijë euro por janë shume pak tuj e pas parasysh qe në të kaluaren kemi pase fatkeqësi si qofte nga uji, vershimet apo zjarri edhe ndihma e komunes ka qenë shume simbolike ne raport me nevojat edhe kerkesat e qytetarve,po me doket që është shume shum e vogel mendoj që kish mujt më keto aspekte qe janë sociale dhe që kanë një rrezikshmeri të lartë për qytetaret,me mir është më qite buxhet ketu ku po them une se sa me shtru nje asfalt 20.000apo 30.000 mijë euro, mendoj që është mire me mendu edhe me e banë një kuzhine popullore për të varferit kur me nje shume simbolike e mbulon komuna

**XHAVIT DRENORI**-une jamë i pa knaqur me komplet proceduren se qysh po behet buxheti se kur te vjen ne kuvend është problem më ndryshu,të projektet që investohen nga grandet dhe prej të hyrave vetanake dhe është mir me e definu saktesisht që sot ose me e prit drejtorin deri ne mbledhjen e radhes me na caktu se cilat projekte prej ketyre që po i kalojm sot janë për vitin e ardhëshem se cilat janë më të hyra vetanake e cilat me grande qeveritare,po ju theme shume sinqerisht sivjet po luhet me fshataret e dobroishecit edhe të Qikatoves si maca me miun me projektin e asfaltit te rruges se janë më të hyra vetanake,as nuk kemi informata se sa jane të hyrat vetanake se sa ka shkuar as a ralizohet a jo,drejtori mundet me i vendos cilat do projekte me i lan më të hyra vetenake edhe cilat grande qeveritare,ne e dimë qe projektet që janë me grande ato ralizohen 100% perndryshe me të hyra vetanake është shumë e pa kjarte edhe po na qet edhe neve ne lajthitje ,une kisha propozu që letecaktohet nese jo sot ne mbledhjen e radhes për vitin 2017 se cilat projekte po mbesin me të hyra vetanake dhe cilat me grande qeveritare.

**IDRIZ HYSENAJ**-jeni ka ankoheni per mos plotesim te buxhetit me të hyra vetanake,per mos vuarjen e rregulave dhe drejtësis ne lokalitete po i humbeni edhe te hyrat vetanake,qysh bahet që 17 vite nuk shkoj asnje investim ne ate

lagje qysh vitin e kaluar ka qene si projekt por sjan kry investimet,sivjet qato investime qe jonë po doje meqite ne votim dhe me mbi votu

**NAIM BAZAJ-** keto ishin propozimet e anëtarve të kuvendit:Projekti i rrëthojse së shkolles me kalu per nxemje dhe më ju shtu edhe 10.000 euro në Polluzhë,Kuvendi ka vendos ne mbledhjen e fundit që prioritet për vitin 2017 nga grandet qeveritare të jenë në ato vende që nuk kanë investudhe që nuk janë ralizu 2014, 2015,dhe 2016 ,Rruga Qikatove e vjeter-Dobroshec ka lapidari i Fehmi Lladroci ,trotuari ne Krajkove që ja ndame 20.000 euro,propozim tjeter ishte që nga 20.000 euro me ju nda lagjes Lugu dhe Tahiraj,Projekti i asfaltimit ne Nekoc te caktohet lagjia Plakaj dhe lagjia Lugu,Fanaj dhe Rrustemi,të hartimi i planit të veprimit për energji të qëndrushme KK Drenas pasi që është projekt 20.000 të merren 10.000 dhe të kalonj në nje projekt të ri Hartimi i planit lokal të veprimit në mjedis,si dhe propozimit tjeter ishte që 20.000 euro të merren nga projekti riparimi dhe rindertimi i kanalizimit në komunen e drenasit të shkonje për kanalizim ne komoranin III,pastaj projekti i infrastrukturies (Asfaltim dhe Kubzaj)ne Drenas fillimisht të shtrohet rruga Gani Elshani e pastaj rrule tjera ne Drenas,Te projekti i inventarizimi i shkollave ne Drenas të merren 4,791. euro dhe të shkojne për rrëthojë ne Nekoc

**NAIM BAZAJ** –hodhi ne votim propozimin e buxhetit me ndryshime që i lexoj dhe në këtë rast kekroj nga anëtaret e kuvendit që të votohet

Me rastin e votimit prezent ishin 21 anëtar

Rezultati i votimit ishte si vijon;

Për:18

Kundër:03

Abstenim:0

**NAIM BAZAJ**-hapi dikutimin për pikën e katërt të rendit të ditës

#### **4. ProjektRregullore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017**

**ISTREF ELSHANI**-të rregullorja e tatimit ne prone deshta me diskutu për fshati Krajkovë ,une e mbaje ndermend se nje mbledhje me heret kemi diskutu per projektin etatimin në pronë e kemi propozu që Krajkova të jete prej zones 3 ne zonen e 4 dhe e kemi votu ne kuvendi ,tash po e shoh që prape është kthy ne zonen e 3

**HAMDI KRASNIQI**-ministria se ka pranu e ka kthy ashtu si ka qene.

**IDRIZ HYSENAJ**-po ndalem të zotat,ketu thuhet se Nekoci kalon nga zona e 3 ne zonen e 4 ,ne zonat urbane i kemi nda Nekoci,Tersteniku,Arllati edhe Gllanasella keto tanat duhet me qene me nje zone pse me u ndrru ku kur janë zona urbane triyat jone zona urbane dhe duhet me qene identike ,pastaj Llapushniku nga zone e 4 kalon ne zonen e 3 ato qe i paraqita per Llapushnikun që azgje nuk ëhstë investuar me qfar prioriteti paskan më shku në zonen e 3-të po lypni tatim prej asaj zone qe nuk është investu azgje,une kisha propozu që Llapushniku jo ne zonen e 3 po ne zonen e 6 ose me ju banë ftes që mos te paguajn hiq

**SOKOL BYLYKBASHI**-sa i perket Projekt rregullores për tatimin ne pronën e paluajtshme për vitin 2017 kamë verejtje tek caktimi i vleres së tregut per m<sup>2</sup> janë 7 kategori te pronave te paluajtshme per kunder faktit se janë të ndara ne zona dhe nën zona tatimore janë caktu vlerat e njejtë për m<sup>2</sup> kjo është kunderthanse,është mir me ban ndryshime e jo vetem print me ja japë, eshte mir me pas zbritje per keto 7 zona prej zonës ne zonë se m<sup>2</sup> ndryshon,sa i perket fushave sportive gjith e dime se jon dy fusha sportive që veprojnë janë ato të mbuluar edhe ato të jonë të pa mbuluara që punojne vetem 6 muja nuk

është mir me u konsideru sikures ato të mbuluara sepse dhe të hyrat i kanë per gjysem më pak, une kisha propozu që fushat sportive qe janë te pa mbuluar nga vlera 200 te zbresin ne 100 euro.

**HAMDI KRASNIQI**-une mendova që arsyetimi do te na kursej ne koh për tregu se si ka ardh deri te ky propozim rregullore,per kete vite kryetari ka formuar një komision profesional i cili është marrë me kete propozim rrgullore ne bashkunim më departamentin e tatimit në prona dhe ne asnjeher nuk kemi te drejt ti bime propozim rregulloren ne kuvend para së të qertifikohet ne departamentin e tatimit ne pronë dhe qdo ndryshim që kekohet tash prap duhet me rigonicu ne departamentin e tatimin edhe me u sjell prap ne kuvend,per nderrimin e disa zonav ne disa fshatra komisioni ka marrë per bazë vete largesine për arsyen se nuk ka pas elemente tjera,të fushat sportive nuk merret per bazë te hyrat,kjo është pasuri të cilën kush e ka i paguan shtetit per pasurin që e ka e jo per të hyrat që i krijon,ndersa vlera per m<sup>2</sup> une po e shoh ne tabel qe ndryshon prej nje zonë në zonën tjeter,nese kuvendi vendos me ndryshu diqka atëher ne propozimet e kuvendit duhet me i dergu ne nivel qëndror nese e marrin parasysh me e kthy prap ne kuvend

**LIMAN KRASNIQI**-të percaktimi i zonave të kategorive,me heret kemi pas tendencia nga fshatrat me u kategorizu ne aspektin urban në zonat sa më të larta për hir të donacioneve,sa i perket klasifikimit që i ka banë komisioni psh. ketu thote zhvillimi i infrastrukturies që është shum e arsyshme qdo zone duhet me u klasifiku në bazë të infrastrukturies,ndersa largesia nga qëndra komunale nuk ka të bez se ajo mundet me qene shum larg qëndrës komunalë po mundet me qenë një infrastruktur shumë e zhvilluar e flera e pasuris nuk mundet me qën e njejt që e percakton largesia psh.Fushtica e ulet kalon nga zona e 3 në zonen e 4 që është shum e arsyshme se nuk ka kurfar infrastrukture Kizhnareka kalon nga zona e 3 ne zonen e 4 eshte e arsyeshme,Llapushniku kalon nga zona e 4 ne zonene e 3 që është e pa arsyshme se rruga kombetare e ka shkatrru sa i perket bizniseve kisha propozu që Llapushniku të mbetet prap ne zonen e 4,Baica nga zona e 4 te kalon ne zonene 3 qfar infrastrukture ka baica,pastaj Tersteniku,Nekoci,Arllati dhe Gllanasella duhet me qene të njejen kategori ne kategorin e 3 ,Gllanasella duhet të kaloj në zonen e 3 ,pastaj Dobrosheci nga zona e 4 te kaloj ne zonen e 3 se nuk e ka një infrastruktur që ka potencu një zhvillim të asaj pjese

**XHAVIT DRENORI**-deshiroj që ta ngris nje shqetesim,kur e kamë parë listen e të nenit 4 ku janë nda kategorit e prones dhe normat tatimore,per mu është shqetesuese se qysh mundet nje prona bujqësore me pas 0.15 %njejt më një pishin respektivisht në nje prona qofte komerciale apo industriale,ne qoft se edhe fabrika e ferronikli realisht po shkon drejt falimentimit keni parasysh se qfar bumi negativ banë ne mirëqenjen e qytetarve tonë ,ne qytetaret tane duhet ti nxism që të merren më bujqësi se skemi tjeter zhvillim,ne qoft ss edhe qato prona bujqësore tatojm une nuk e di qysh po dojme më i nxit ata,per ndryshe 0.15%mbetet per prona bujqësore unë thamë që pishinave edhe gjithave të ju ngrisin në 0. 20%sepse ata po fitojnë prej pronës po krojojn të hyra

**HAMDI KRASNIQI**-ligji e percakton shume mir se norma minimale është 0.15% deri me 1 %komuna ka te drejt normen më caktu dhe me pak se 0.15% nuk ka dhe e kemi rujt ketë minimum si për pronat rezidenciale,shtëpi dhe për pronat bujqësore ndersa maksimumi është 20% për pronat industriale dhe depot ,kemi ber dallimin pronat industriale,pronat komerciale e kanë 0.16 ne mundemi ta nderrojm tarifen e normave por është mendu është e kapshme dhe për ti

stimulu ,e vlera është diqka tjeter me vler formohet baza tatimore here norma  
dele fatura e tatimit.

**SABRIJE KUKAJ**-te Qikatova e re që është ne zonen 2 nuk jamë kunder azgje  
pse është ne ata zona po jamë kunder për arsy se ketu është aprovu prej  
kuvendit ajo zonë me u kthy në zonë ndertimore prej tokes bujqësore,faktikisht  
nuk është ber asnje hap në atë drejtim dhe asnje njeri nuk merr as leje  
ndertimi e as nuk mundet ta perkthej pronën se ju thuhet se ështe tokë me  
komusacion ,me vendim te kuvendit e kame pa që është kthy nga toka  
bujqësore ne toke ndertimore dhe është marr pelqimi nga ministris dhe duhet  
te ndermarrim diqka sa me shpejt se njerzt ti perkthejn pronat që i kanë ble  
edhe shtepit që i kanë ndertu ne to pasi që shtë me vendim të kuvendit.

**NAIM BAZAJ**-kërkoj që me keto keto ndryshime si;fushat sportive të hapura të  
paguajnë nga 100 euro si dhe fshatrat Baicë,Dobroshec dhe Krejkove nga zona  
e III të kalojne në zonën e IV-të

**NAIM BAZAJ**- hodhi në votim projekt rregulloren e tatimin në prone për vitin  
2017 me ndryshime


Me rasti e votimit prezant ishin 20 anëtar  
Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:20

Kundër:0

Abstenim:0

**NAIM BAZAJ**- shpalli të mbyllur këtë seancë rreth orës 14:30.

Proces mbajtësir  
  
Albulema Bujupi



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës  
  
Naim Bazaj